



**REPUBLIKA E SHQIPERISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK**

**DOKUMENTAT STANDARDE TË PROCEDURËS
KËRKESË PËR PROPOZIM
SHËRBIME¹**

**“HARTIM I PROJEKTIT TË ZYRAVE
POSTARE”,**

I. NJOFTIMI I KONTRATËS

Seksioni 1. Autoriteti Kontraktor

1.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Posta Shqiptare sh.a.
Adresa Rruga “Reshit Çollaku”, nr. 4, Tiranë
Tel/Fax _____
E-mail nikolin.lleshi@postashqiptare.al
Faqja e Internetit www.postashqiptare.al

1.2 Lloji i autoritetit kontraktor:

Institucion qendror	Institucion i pavarur
Njësi e qeverisjes vendore	Tjetër
	X

1.3 Kontratë në kuadrin e një Marrëveshjeje të veçantë ndërmjet Shqipërisë dhe një Shteti tjetër

Po	Jo	X
----	----	----------

Seksioni 2 Objekti i kontratës

2.1 Numri i referencës së procedurës/lotit_ REF-53899-03-11-2020

2.2 Lloji i “Kontratave Publike për Shërbime”

Konkurs Projektimi	Shërbime Konsulence	Shërbime të tjera
		X

2.3 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër

Po	Jo	X
----	----	----------

2.4 Lloji i Marrëveshjes Kuadër

Me një Operator Ekonomik

Me disa operatorë ekonomikë

Të gjitha kushtet janë të përcaktuara	Po	Jo
---------------------------------------	-----------	-----------

Në Marrëveshjen Kuadër me 1 Operator Ekonomik, kur të gjitha kushtet janë të përcaktuara, të jepen arsyet e përzgjedhjes së kësaj lloji Marrëveshje Kuadër

--

2.5 Numri i operatorëve ekonomikë me të cilët do të perfundojë Marrëveshja Kuadër:_____
(Këtu duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër).

2.6	Kushtet që do të zbatohen në rastin e rihapjes së konkurimit dhe/ose përdorimi i mundshëm i blerjes elektronike.	
-----	--	--

2.7 Autoriteti kontraktor / Autoritetet kontraktore, të cilat do të lidhin marrëveshjen kuadër: _____

2.8 Përshkrim i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër

1. Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës **2,279,340** (dy milion e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind e dyzet) Lekë, pa TVSH
2. Në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është _____**
3. Burimi i Financimit **Të ardhurat e shoqërisë _____**
4. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër **“Hartim i Projektit të Zyrave Postare”**

2.9 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja në muaj ose ditë **45**

ose

duke filluar nga // me përfundim në //

2.9.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër

Kohëzgjatja në muaj: *ose* **ditë:** (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër*(jo më shumë se (4) vjet)*)

Ose duke filluar nga // (dd/mm/vvvv)

Përfunduar më // (dd/mm/vvvv)

2.10 Vendi i kryerjes së shërbimeve, objekt i kontratës/marrëveshjes kuadër:

2.11 Ndarja në Lote:

Po Jo X

Nëse po,

2.12 Përshkrim i shkurtër i loteve

(Objekti dhe fondi limit i loteve)

1

2.

3.

etj.

Një Ofertues mund të aplikojë për [një lot], [disa lote], [të gjitha lotet]. Për çdo lot paraqitet një ofertë e veçantë.

2.13 Optionet:

Numri i rinovimeve të mundshme (*nëse ka*):

Ose: nga në

2.14 Do të pranohen variantet:

Po	Jo	X
----	----	----------

2.14.1 Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë përdorur standartet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shqerisë së Informacionit:

Po Jo **X**

2.15. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rastin kur standardet janë të pa-aplikueshme, është marrë miratimi paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:

Po	Jo	X
----	----	----------

Seksioni 3 Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik

3.1 Kriteret e Pranimiit shtojcës 4

Seksioni 4 Procedura

4.1 Lloji i procedurës: Kërkesë për propozim

Procedurë prokurimi e rishpallur

Po

Jo

X

Nëse është procedurë e rishpallur të plotësohen të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

- a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së prokurimit të anuluar
- b) Objekti i prokurimit të procedurës së prokurimit të anuluar
- c) Fondi limit i procedurës së prokurimit të anuluar

4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) çmimi më i ulët **X**

Ose

B) oferta ekonomikisht më e favorshme

lidhur me rëndësinë: Çmimi **pikë**
etj. **pikë**

Autoriteti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për çdo kriter vlerësimi të vendosur.

4.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **24/03/2020** (dd/mm/vvvv) Ora: **10:00**

Vendi: _____

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al

4.4 Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **24/03/2020** (dd/mm/vvvv) Ora: **10:00**

Vendi: _____

Informacioni mbi ofertat paraqitura me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.

4.5 Periudha e vlefshmërisë së ofertave: **150** (e shprehur në ditë)

4.6 Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip	X	Anglisht
Tjetër	_____	

Seksioni 5 Informacione plotësuese

5.1 Dokumenta me pagesë (i zbatueshëm vetëm për procedurat që nuk zhvillohen me mjete elektronike):

Po	Jo	X
----	----	----------

Nëse Po

Monedha	_____	Çmimi	_____
---------	-------	-------	-------

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së DT tek Operatorët Ekonomikë. Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të kontrollojnë DT para blerjes së tyre.

5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e dokumentave të tenderit)

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi **12/03/2020**

Njoftimi i kontrates për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor, i cili do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri	Posta Shqiptare sh.a.
Adresa	Rruga “Reshit Çollaku”, nr. 4, Tiranë
Tel/Fax	
E-mail	nikolin.lleshi@postashqiptare.al
Faqja e Internetit	www.postashqiptare.al

2. Lloji i procedurës se prokurimit: “Kërkesë për Propozim”;

3. Numri i referencës së procedurës/lotit REF-53899-03-11-2020

4. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: “Hartim i Projektit të Zyrave Postare”,

5. Fondi limit 2,279,340 (dy milion e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind e dyzet) Lekë, pa TVSH.

6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: do të jetë 45 (dyzet e pesë ditë) kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës..

7. Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:
Data: 24/03/2020, ora 10:00.

8. Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:
Data: 24/03/2020, ora 10:00.

II. UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË

Seksioni 1. Hartimi i ofertës

- 1.1 Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.
- 1.2 Operatori Ekonomik përballon kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij. Autoriteti Kontraktor nuk është përgjegjës për këto kosto.
- 1.3 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertes duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme e të printuar duhet të pajisen me initiale ose të nënshkruhen nga Personi (-at) e autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i firmosur nga Personat e Autorizuar.
- 1.4 Në rast të ofertave të paraqitura nga një bashkim operatorësh ekonomikë, oferta duhet të shoqërohet me Prokurën/autorizimin me Shkrim për Personat e Autorizuar që do të përfaqësojnë bashkimin gjatë procedurës së prokurimit.
- 1.5 **Oferta duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:**
- a) Formulari i Ofertës Ekonomike, plotësuar sipas Shtojcës 1 të DT.
 - b) Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur sipas Shtojcës 1/1.
 - c) Dokumentat që lidhen me objektin e prokurimit (*skica, katalogje, kampione etj*)
_____,
_____,
_____.
 - ç) Dokumentat dhe vërtetimet e kërkuara në Shtojcën 7.
 - d) (Opsion) ofertën alternative teknike (nëse parashikohet).
- Një Operator Ekonomik duhet të paraqesë vetëm një ofertë.
- 1.6 Fshthtësia e procesit sipas nenit 25 të LPP-së.
- 1.7 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, Operatorët Ekonomikë duhet të dorëzojnë vetëm ofertën origjinale të futur në një zarf jotransparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: “Ofertë për kryerjen e _____ shërbimeve; Nr e Njoftimit _____
“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS, DHE JO PARA _____
(dd/mm/vv) orës _____”.

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al.

- 1.8 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose të tërheqin ofertat e tyre, me kusht që ky modifikim ose tërheqje të kryhet para afatit kohor përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet, ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit Kontraktor me shkrim para datës së fundit për dorëzimin e ofertave. Zarfë që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet përkatësisht: **“MODIFIKIM OFERTE”** ose **“TËRHEQJE OFERTE”**.

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, ofertuesi mund të modifikojë në çdo kohë ofertën deri përpara përfundimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave, pa patur nevojë për ndonjë komunikim me autoritetin kontraktor, pasi veprimet kryhen në llogarinë e tij, në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al.

Seksioni 2 Përlllogaritja e ofertës ekonomike

- 2.1 Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës Ekonomike bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar shërbimet që do të kryhen, sasi të dhe çmimin e tyre.
- 2.2 Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën Shqiptare (Lek), duke përfshirë edhe tatimet që zbatohen, por pa përfshirë TVSH. Nëse çmimet kuotohen në një monedhë të huaj, atëherë ato duhet të kthehen në Lekë Shqiptare sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.
- 2.3 Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës Ekonomike, çmimet totale të ofertës të të gjitha Shërbimeve, pa TVSH. Vlera e TVSH, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të ofertës.
- 2.4. Në rastin e një marrëveshje kuadër ku të gjitha kushtet NUK janë përcaktuar, çmimet për kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk janë të fiksuara; ato janë objekt i ndryshimit pas një mini-konkurrimi midis operatorëve ekonomikë, palë në marrëveshjen kuadër.

2.5 Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës

Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon që nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 ditë nga përpara përfundimit të afatit kohor për vlefshmërinë e ofertave, autoriteti kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund t'a refuzojë këtë kërkesë me

shkrim pa humbur të drejtën për rimbursim të sigurimit të ofertës, kur ka një tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës njofton Autoritetin Kontraktor me shkrim, dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti Kontraktor lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti Kontraktor do të refuzojë ofertën.

2.6 Veprimet e jashtëligjshme sipas Nenit 26 të LPP-së

Seksioni 3. Vlerësimi i ofertave

3.1 Kriteret e përzgjedhjes

(Opsioni 1) Çmimi më i ulët i ofertës së kualifikuar.

Kontrata do t'i akordohet atij Ofertuesi që ka ofruar çmimin më ulët të ofertës.

(Opsioni 2) Oferta ekonomikisht më e favorshme.

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar qartë pesha specifike e secilit kriter dmth sa pikë do të ketë çdo kriter dhe si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën do të llogariten pikët e ofertuesve në këtë rast është:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Ku:

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për çdo kriter të vlerësuar

Pikët për çdo kriter përlllogariten sipas formulës:

$$Pk1 = Vmin k1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmin k1 _____ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Sqarim

Si kriter vlerësimi duhet të përzgjidhet vetëm njëri prej opsioneve . Plotësimi i të dy opsioneve e bën procedurën të pavlefshme.

Në rastin e prokurimit të marrëveshjes kuadër, kur objekt i kësaj marrëveshje janë biletat e transportit ajror ndërkombëtar, në vend të çmimit do të përdoret marzhi i fitimit i shprehur në përqindje.

3.2 Korrigjimi i gabimeve dhe pjesët e hequra

3.2.1 Autoriteti Kontraktor korrigjon ato gabime në ofertë, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi zbulohet gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti Kontraktor e njofton menjëherë Ofertuesin në fjalë me një njoftim me shkrim/elektronik mbi çdo korrigjim të tillë dhe mund të vazhdojë me ndryshimin e gabimit, me kusht që Ofertuesi t'a ketë miratuar këtë komunikim që i është bërë. Nëse Ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë oferta do të refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës, nëse ekziston një e tillë.

3.2.2 Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

- në rast se ka mospërputhje ndërmjet shumave të shprehura në shifra dhe atyre në fjalë, atëherë do të mbizotërojnë shumat e shprehura në fjalë, me përjashtim të rasteve kur shumat në fjalë lidhet me një gabim aritmetik;

- nëse ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës së përgjithshme që merret nga shumëzimi i çmimit njësi dhe sasisë, atëherë do të mbizotërojnë çmimi njësi, dhe rrjedhimisht duhet të korrigjohet shumat në total, nëse ka një gabim në një shumë total, që korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nëntotaleve, atëherë do të mbizotërojnë nëntotali dhe totali duhet të korrigjohet. Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për ofertuesin. Nëse ofertuesi nuk i pranon ato, atëherë oferta e tij do të refuzohet. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë $\pm 2\%$ e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

3.4 Ofertat anomalisht të ulëta

3.4.1 Nëse oferta e dorëzuar, rezulton anomalisht e ulët në lidhje me shërbimet e ofruara, atëherë Autoriteti Kontraktor i kërkon Ofertuesit në fjalë të justifikojë çmimin e ofruar. Nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim që të bindë Autoritetin Kontraktor, atëherë ky i fundit ka të drejtë të refuzojë ofertën.

3.4.2 Oferta do të cilësohet anomalisht e ulët sipas përcaktimit të bërë në nenin 66 të Kreut VII të RrPP .

Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25 përqind e fondit limit të përlllogaritur.

Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85 përqind

e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP.

Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe dokumentojë me prova shkresore sqarimet mbi elementin/elementët e veçantë të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Formula që do të zbatohet për të cilësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ka tre ose më shumë oferta të vlefshme është si më poshtë:

O – Oferta

M_O – Mesatarja e Ofertave të vlefshme

n – Numri i Ofertave të vlefshme

Z_M – Zbritja e Mundshme

$$M_O = O_1 + O_2 + O_3 + \dots O_n / n$$

$$Z_M = 85 \% M_O$$

Vlera e Ofertës që vlerësohet $< Z_M$, si rrjedhim Oferta është Anomalisht e Ulët

Në rastin kur kriter vlerësimi është përzgjedhur oferta ekonomikisht më e favorshme, do të verifikohet nëse ofertat janë anomalisht të ulëta vetëm nëse oferta e klasifikuar me pikët më të larta e ka ofertën ekonomike me vlerën më të ulët.

3.5. Ankimi administrativ në dispozicion të Operatorëve Ekonomikë sipas nenit 63 të LPP-së.

Seksioni 4. Nënshkrimi i kontratës

4.1 Njoftimi i fituesit

Autoriteti Kontraktor njofton Ofertuesin fitues, përmes dërgimit të njoftimit të fituesit, siç parashikohet në Shtojcën 13. Një kopje e këtij njoftimi publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, siç kërkohet në Nenin 58 të LPP-së.

4.2 Sigurimi i kontratës

4.2.1 Autoriteti Kontraktor kërkon sigurim për ekzekutimin e kontratës. Shuma e sigurimit për ekzekutimin e kontratës do të jetë 10 % e vlerës së kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, sipas Shtojcës 19 të DT, duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet para nënshkrimit të kontratës.

- 4.2.2 Sigurimi për egzekutimin e kontratës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:
- i. garanci bankare,
 - ii. garanci sigurimi,

Ky formular nuk përdoret nga autoritetet kontraktore në rastin e prokurimit të kontratave sektoriale.

4.3 Njoftimi i kontratës së nënshkruar

Në pajtim me RrPP, pas nënshkrimit të kontratës, autoriteti kontraktor dërgon një njoftim në APP për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Shënim: Autoritetet kontraktore nuk duhet të ndërhyjnë për të bërë asnjë lloj ndryshimi në dokumentat e tenderit nga pika 1 në pikën 4.

III. SHTOJCAT

Shtojcat e mëposhtme janë pjesë përbërëse e DT:

Dokumentat Standarde të Tenderit

- Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike
- Shtojca 1/1: Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur
- Shtojca 2: Formulari i Ftesës për Ofertë (në rastin e Marrëveshjes Kuadër)
- Shtojca 3: Formulari i Informacionit Konfidencial
- Shtojca 4: Deklaratë mbi përmbushjen e Kritereve të Përgjithshme
- Shtojca 5: Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike dhe të Termave të Referencës nga operatori ekonomik
- Shtojca 6: Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit
- Shtojca 7: Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes
- Shtojca 8: Specifikimet teknike
- Shtojca 9: Planifikimi i kontratave në marrëveshjen kuadër
- Shtojca 10: Sherbimet dhe Grafiku i ekzekutimit
- Shtojca 11: Termat e Referencës
- Shtojca 12: Formulari për Njoftimin e Skualifikimit
- Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit
- Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër
- Shtojca 15: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
- Shtojca 16: Kushtet e Veçanta të Kontratës
- Shtojca 17: Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar
- Shtojca 18: Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike
- Shtojca 19: Formulari i Sigurimit të Kontratës
- Shtojca 20: Formulari i Njoftimit të Anullimit
- Shtojca 21: Formulari i Ankesës në Autoritetin Kontraktor
- Shtojca 22: Draft Marrëveshja Kuadër ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara
- Shtojca 23: Draft Marrëveshja Kuadër ku Jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara

Shtojca 1

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

* * *

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: (objekti)

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

1	2	3	4	5	6
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Sasia	Çmimi Njësi	Çmimi Total	Afati
Çmimi Neto)					
TVSH (%)					
Çmimi Total					

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar ne dokumentat e tenderit)

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]

DEKLARATË

Për paraqitje Oferte të Pavarur

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë: _____; nga Autoriteti Kontraktor: _____; me objekt: _____; me fond limit: _____.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik _____, në mbështetje të nenit 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

Unë vërtetoj, në interes të: _____ që:
(Emri i operatorit ekonomik)

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimet publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues potencial, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

- a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

(Emri dhe Firma e Personit të Autorizuar për Përfaqësim të Ofertuesit)

(Titulli sipas pozicionit në punë) (Data)

Shtojca 2

[Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor në Marrëveshjen Kuadër gjatë rihapjes së

procesit të mini-konkurrencës]

FTESA PËR OFERTË

(shkruani emrin e Autoritetit Kontraktor)

fton për të paraqitur oferta në procedurën për kryerjen e shërbimeve të mëposhtme:

.....
.....
.....

(jepni një përshkrim të saktë të objektit të kontratës dhe sasise siç përkufizohet në Dokumentat e Tenderit (DT).

Vendi i kryerjes së shërbimit

(jepni një përshkrim të shkurtër)

Kohëzgjatja e shërbimit _____

Oferta duhet të paraqitet

.....

[Jep adresën e saktë]

Përpara

.....

[Përcaktoni datën dhe orën e afatit përfundimtar]

Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese

Forma e komunikimit:

Me shkrim ____

Elektronik (email, fax etj.) _____

Shtojca 3

LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

(Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial	Numri i faqes dhe pikat e DT që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial	Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial

KUJDES

Çdo e dhënë, që nuk është regjistruar si e dhënë konfidenciale, do të konsiderohet se titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës dhe Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për publikimin e këtij informacioni.

Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik.

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shtojca 4

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.
- Personi/at në cilësinë e ***anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik***, si më poshtë:

_____ etj.
nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP¹.
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).
- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shtojca 5

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik, që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e _____ të personit juridik _____ deklaroj se:

Përbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

DEKLARATË
Mbi konfliktin e interesave

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejta ose të tërthorta që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohej në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejta ose të tërthorta nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në

kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 7

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;*
- dh. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional:

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ofertues duhet të paraqesë Vërtetim nga Administrata Tatimore mbi xhiron mesatare vjetore për vitet (2017, 2018, 2019) e cila duhet të jetë, në një vlerë jo më të vogël se 95% e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

2.3. Për kapacitetin teknik:

2.3.1 . Operatori Ekonomik duhet të paraqesë furnizime me natyrë të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një *ent publik ose faturave tatimore të shitjes*, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të realizuara.

2.3.2. Operatoret ekonomik duhet të disponojnë licensat e nevojshme profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për studim/projektim (lëshuar nga MZHUT/MEI) lidhur me ekzekutimin e kontratës ku të përfshihen kategoritë për projektim në kategoritë si më poshtë (sipas modelit të miratuar me Vendim Të Këshillit të Ministrave nr. 943, datë 28.12.2016):

1. PROJEKTUES ARKITEKT

- 2 a- Projektim arkitekturor për objekte banimi—objekte industriale—objekte turistike.
- 2 c- Projektim interiere.
- 2 d- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.

2. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

- 3a- Objekte civile-industriale—turistike prej murature e skelet betonarme deri në 5 kate.

3. PROJEKTUES INSTALATOR

- 4a- Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.
- 4b- Projektim të instalimeve termo teknike—kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.
- 4f- Projektim i sistemeve kundra zjarrit.

4. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

- 5b- Projektim furnizim me ujë—kolektorë shkarkimi.

5. PROJEKTUES GJEODET

- 8a- Rivlime inxhinierike.
- 8b- Rivlime inxhinierike kadastrale
- 8d- Bazamente gjeodezike

8e- Projektim fotogrametrik dhe hartografik

6. PROJEKTUES ELEKTRIK

4c- Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.

4j-Projektim i rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e detektimit etj (per objektet civile dhe industriale)

7. STUDIM GJEOLLOGO INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

9a- Studim/Vlerësim gjeollogo inxhinierik i truallit për objekte civile-ekonomike deri 5 kate.

Kandidati/Ofertuesi i huaj duhet te ekuivalente (njesoje), licensen profesionale qe disponon, te leshuar nga vendi i origjines, prane Ministrise se Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

2.3.3 . Operatori ekonomik duhet te paraqese licencat qe do te perfshije për zbatimin e kontratës ne kategorite si me poshte shenuar, shoqeruar patjeter me Diplome, CV.

1 (nje) inxhinier infrastrukture/ndërtimi/rruga ura

1 (nje) nje akrkitekt/urbanist

1 (nje) inxhinier mekanik

1 (nje) Inxhinier Hidroteknik

1 (nje) inxhinier elektrik/elektroteknik

1 (nje) inxhinier gjeodet (makshejder)

1 (nje) inxhinier gjeolog

Për inxhinierët e mësipërm Operatori ekonomik duhet të paraqesë këto dokumenta: licence profesionale individuale si dhe të jenë të përfshirë në licensën e shoqërisë, kontratë pune të vlefshme, diplomë, cv, libreze pune si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 muaj.

2.3.4. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Gusht 2019 – Janar 2020, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. ***Operatori ekonomik duhet të ketë një numer mesatar prej 10 (dhjetë) punonjësish të siguruar për periudhën Gusht 2019 – Janar 2020.***

2.3.5. Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponoje dhe të paraqesë këto çertifikata ne perputhje me objektin e prokurimit:

- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 9001:2015 (per sistemin e menaxhimit te cilesise)**, (e vlefshme) ose ekuivalente
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 14001:2015 (per sistemin e menaxhimit te mjedisit)**, (e vlefshme) ose ekuivalente,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **OHSAS 18001:2007 (per sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune)**, (e vlefshme) ose ekuivalente,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **BS PAS 99:2012 (per sistemin e menaxhimit te integruar)**, (e vlefshme) ose ekuivalente.

2.3.6. Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponojë dhe të paraqesë - Licencë, Grupi 2-Shërbime ekspertizë ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis, Nënkatëgoria: Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me vlerësimin e ndikimit në mjedis-Kodi: III.2.A.

2.3.7. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacionin se disponon në pronësi ose me qira

- a) 2 Autovetura 4+1
- b) GPS
- c) Total Station

Per kete OE te paraqese:

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme) si dhe certifikaten e transportit, dhe për mjete të siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit dhe certifikaten e transportit (te vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerash/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë akte të çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c) Për mjetet e marra me qeratë të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë e cili duhet të përshijë afatin e objektit të tenderimit prokurimi.*
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr.9.(Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Hartim i Projektit të Zyrave Postare, për 40 objekte sipas filialeve të Posta Shqiptare sh.a, si më poshtë:

Filiali Tiranë

1. Zyra Postare Nr.19;
2. Zyra Postare Vaqar;
3. Zyra Postare Krrabë;
4. Zyra Postare Ndroq;
5. Zyra Postare Kashar.

Filiali Durrës

1. Zyra Postare Durresi Nr.2 (Rikonstruksion nga Fondi Qeverisë);
2. Zyra Postare Durresi Nr.3 (Rikonstruksion nga Fondi Qeverisë);
3. Zyra Postare Durresi Nr.4 (Rikonstruksion nga Fondi Qeverisë).
4. Zyra Postare Manëz;
5. Zyra Postare Fushë - Krujë;
6. Zyra Postare Krujë, Qendër.

Filiali Elbasan

1. Zyra Postare Lunik – Librazhd;
2. Zyra Postare Zdrajsh – Verri – Librazhd;
3. Zyra Postare Farret – Librazhd;
4. Zyra Postare Mlizë;
5. Zyra Postare Shalës;
6. Zyra Postare Gostimë.

Filiali Fier

1. Zyra Postare Qendër-Mallakastër

Filiali Vlorë

1. Zyra Postare Kuç

Filiali Lushnjë

1. Zyra Postare Ballagat;
2. Zyra Postare Golem;
3. Zyra Postare Tërbuf;
4. Zyra e Administratës Lushnjë (Kati I-rë).

Filiali Berat

1. Zyra Postare Velabisht

Filiali Korçë

1. Zyra Postare Ersekë-Qendër;
2. Zyra e Administratës së degës Ersekë;
3. Zyra e Administratës Korçë;
4. Zyra Postare Korça Nr.1;
5. Zyra Postare Devoll.

Filiali Gjirokastrë

1. Zyra Postare Ballaban;
2. Zyra Postare Qesarat;
3. Zyra Postare Erind;
4. Zyra Postare Sofratikë;
5. Zyra Postare Kardhiq

Filiali Mat

1. Zyra Postare Baz;
2. Zyra Postare Gjoricë;
3. Zyra Postare Bulqizë e re;
4. Zyra Postare Peshkopi (Dobrovë).

Filiali Kukës

1. Zyra Postare Kukës Qendër;
2. Zyra Postare Qendër – Has.

DETYRË PROJEKTIMI

● **PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM**

“Posta Shqiptare” Sh.a zhvillon aktivitetin e shërbimit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë duke synuar rritjen e cilësisë të të gjitha llojeve të shërbimit për klientët dhe gjithashtu përmirësimin e kushteve të punës për punonjësit e saj.

● **OBJEKTIVI**

Është hartimi i projekt - preventivave për punimet e rikonstruksioneve të Objekteve të Postës Shqiptare sh.a, që synon të krijojë ambiente bashkëkohore pune, rritjen e cilësisë së shërbimeve, përmirësimin e imazhit të saj, ambjentëve përreth dhe infrastrukturës.

Projektet e rikonstruksioneve të këtyre Objekteve, duhet të realizojnë dhe mundësojnë studimin dhe analizimin e problemeve ekzistuese si dhe dhënien e zgjidhjeve më optimale për realizimin e qëllimit përfundimtar.

● **STANDARDET NË PROJEKTIM**

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse.

FILIALI TIRANË

1. ZYRA POSTARE NR 19

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Zyra e postës Nr.19, ndodhet në rrugën “Njazi Meka” Tiranë, rreth 3 km në verilindje të qendrës së Tiranës në kryqëzimin e rrugës “Njazi Meka” me rrugën “Sul Gjashta” me një sipërfaqe njësie prej 68.7 m².

Në veri të pronës, rreth 3 m, është rruga “Sul Gjashta” dhe më tej shtrihen ndërtesa banimi 2-5 katëshe.

Në juglindje të pronës, rreth 200 m ndodhet shkolla 9-vjeçare “Ramazan Jarani”.

Në perëndim dhe në lindje të pronës, ndodhen godina banimi ekzistuese 2-5 katëshe.

Zyra postare është në katin përdhe të një pallati 6-katësh, e ndërtuar në vitin 1978. Ndërtesa ka konstruktion të kombinuar me kollona, trare dhe soleta b/arme me murë tulle me trashësi 25 cm dhe 12 cm për muret e jashtme e të brendshme. Hyrja e postës është e veshur me pllaka të mëdha graniti ndërsa shkallët hyrëse janë me mermer.

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Gjendja ekzistuese e ndërtesës është e keqe pasi objekti është ndërtuar para shumë kohësh. Objekti është i gjithi i amortizuar si brenda edhe jashtë dhe ka nevojë për rinovim.

Momentalisht objekti përbëhet nga dy dhoma. Në muret e brendshme të objektit ka gjurmë të theksuar lagështire dhe muret janë të plasaritura. Dyshemeja e objektit është e shtruar me pllaka porcelani ngjyrë bardhë e zi, të cilat janë të dëmtuara dhe të thyera. Dyert, dritaret, tavanet e varura, suvatimet dhe rrjeti elektrik është totalisht i amortizuar dhe i vjetër kjo si rjedhje e mos investimit shumë vjeçar. Ndiçimi është i dobët dhe linjat elektrike janë të dëmtuara.

Banakët e shërbimit, tavolinat, karriget e punonjësve dhe sendet e tjera në Zyrën Postare Nr. 19 janë krejtësisht të amortizuara.

Tualetët janë në një gjendje të rënduar, pasi pajisjet hidrosanitare dhe instalimet hidraulike janë tejet të amortizuara dhe jo funksionale.

Dritaret e objektit janë të siguruara me qepenë metalik. Në fasadën e jashtme ballore të kësaj zyre postare (mbi derë) është vendosur reklama e Zyrës Postare si dhe një kuti postare e madhe.

2. ZYRA POSTARE VAQAR

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Zyrat e postës Vaqar ndodhen në fshatin Vaqarr të Tiranës, rreth 11.5 km në jugperëndim të Tiranës.

Prona ndodhet në rrugën hyrëse të fshatit, e cila lidhet me rrugën nacionale Tiranë - Durrës, në anën jugore të saj. Në veri të pronës, rreth 10 m, ndodhet rruga hyrëse e fshatit, ndërsa në jug ndodhen shtëpi banimi 2-3 katëshe. Zyra Postare ka një sipërfaqe 78.3 m² në katin përdhe të një ndërtese 1-katëshe, e ndërtuar në vitet 80. Ndërtesa ka konstruksion të kombinuar, kollona, trarë, mur tulle dhe e mbuluar me çati me tjegulla.

Aktiviteti i postës kryhet në katin përdhe të një ndërtese 1-katëshe, e cila nga brenda përbëhet nga ambientet e shërbimit të klientit, dy zyra, korridori dhe tualeti.

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Zyra postare Vaqar është e gjithi e amortizuar si brenda edhe jashtë dhe ka nevojë për rinovim. Brenda të gjitha suvatimet, dyert, dritaret dhe rrjeti elektrik është totalisht i amortizuar dhe i vjetër kjo si rrjedhojë e mos investimit shumë vjeçar. Ndëçimi është i dobët dhe i dëmtuar dhe tavanet e varura janë të dëmtuara rëndë. Shtresat e pllakave janë të dëmtuara. Tualetët janë në një gjendje të rënduar pasi pajisjet dhe instalimet hidraulike janë tejet të amortizuara. Banakët e shërbimit, tavolinat dhe karriget e punjonjësve janë krejtësisht të amortizuara. Të gjithë dritaret dhe dyert janë të amortizuara. Në tërësinë e vet të gjitha punimet brenda kanë nevojë për një rikonstruksion total. Tabela treguese e zyrës postare shumë e vjetër, e dëmtuar dhe mban logon e vjetër të Postës Shqiptare.

3. ZYRA POSTARE KRRABE

A- PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Zyra Postare Krrabë ndodhet në fshatin Krrabë të Tiranës, rreth 26 km në juglindje të qytetit të Tiranës.

Prona ndodhet në qendër të fshatit, buzë rrugës kryesore të Krrabës, në anën jugore të saj.

Në jug të pronës, është truall i lirë, ndërsa në veri rreth 15 m, është rruga kryesore e Krrabës dhe më tej rreth 60 m, është shkolla e mesme e fshatit.

Në perëndim të pronës, rreth 15 m, është godina e ish Kino Klubit, ndërsa në lindje është rruga e brendshme e fshatit e më tej rreth 20 m është një pallat 5-katësh.

Zona ku ndodhet prona është kryesisht zonë rurale, me një nivel të ulët ekonomik. Përreth tij ndodhen godina banimi, lokale, dyqane.

Vendodhja e pronës është i mirë, pasi është në rrugën kryesore të fshatit. Infrastruktura dhe rrugët janë në gjendje të mirë. Prona, ndodhet në katin përdhe të një ndërtese 2-katëshe, e ndërtuar në vitet 80' e cila është e rikonstruktuar. Ndërtesa ka konstruksion të kombinuar me kollona, trarë dhe soleta b/arme me mur tulle. Fasada e ndërtesës është e suvatuar dhe e lyster. Dera e jashtme është me profil duralumini me xham dhe e siguruar me qepenë metalik. Ndërtesa ka hyrje kryesore në anën veriore të saj, direkt nga rruga kryesore, ku behen edhe shërbimet me klientin. Trotuari para pronës është i shtruar dhe i sistemuar.

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Zyra Postare Krrabë është në gjendje të amortizuar. DysHEMEJA e të gjitha ambienteve e objektit janë të shtruara me pllaka gres por nivelimi nuk është i mirë, pra ka disnivel dhe pllakat me

kalimin e kohës e kanë humbur ngjyrën e tyre. Muret dhe tavanet janë të suvatuara e të lyera po me shenja lagështie dhe plasaritje. Dyert e dritaret janë duralumini me xham kurse banaku i sportelit është realizuar me melaminë dhe shufra alumini me xham.

4. ZYRA POSTARE NDROQ

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Zyra Postare Ndroq ndodhet në fshatin Ndroq të Tiranës, rreth 22 km në jugperëndim të Tiranës. Prona ndodhet buzë rrugës nacionale Tiranë - Durrës, në anën veriore të saj. Në veri të pronës, rreth 20 m është rruga nacionale Tiranë - Durrës, ndërsa në jug janë shtëpi banimi 2-3 kateshe. Në perëndim të pronës, rreth 5m, është ambulanca e fshatit, më tej rreth 35 m është rruga e fshatit dhe më tej rreth 120m është shkolla “Sadri Nuri”. Zona ku ndodhet prona është kryesisht zonë rurale, të një niveli të ulët ekonomik. Përreth tij ndodhen godina banimi, lokale, dyqane. Akses i pronës është i mirë pasi ndodhet direkt në rrugë nacionale. Infrastruktura dhe rrugët janë në gjëndje mesatare.

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Zyrat Postare Ndroq, Tiranë e kryen aktivitetet e saj në katin përdhe të një ndërtese 2-katëshe, me sipërfaqje 79.8 m², e cila nga brenda përbëhet nga ambientet e shërbimit të klientit, zyrë, tualeti dhe korridori. Ambientet janë të pa rikonstruara dhe paraqiten në gjendje jo të mirë. Në muret brenda dhe jashtë objektit ka shenja të lagështirës. Në fasadën e jashtme ballore të kësaj zyre postare (mbi derë) është vendosur reklama e Zyrës Postare si dhe një kuti postare e madhe. Dyshemeja e të gjitha ambienteve është e shtruar me pllaka gres po nga kalimi i viteve kanë humbur ngjyrën e tyre. Dyert e dritaret janë duralumini me xham. Banaku i sportelit është realizuar me melaminë dhe shufra alumini me xham. Tualeti është i shtruar në dyshme me pllaka gres dhe i veshur në mure me pllaka majolike, si dhe i pajisur me pajisje hidrosanitare porcelani.

5. ZYRA POSTARE KASHAR

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Zyra Postare Kashar, ndodhet në fshatin Kashar të Tiranës, rreth 13 km në veriperëndim të Tiranës. Prona ndodhet buzë rrugës së fshatit, në anën perëndimore të autostradës Tiranë - Durrës, rreth 1.5 km në jugperëndim të mbikalimit të Kasharit. Në veri të pronës, janë shtëpi banimi 2-3 kateshe dhe 200m më tutje është Nënstacioni elektrik i Kasharit. Rreth 600m larg Zyrës Postare Kashar ndodhet godina e Qendrës Kulturore. Në perëndim të pronës rreth 20 m është kryqëzimi i rrugës së brendshme të fshatit me rrugën që shkon për në fshatin Mazrek. Përreth Zyrës Postare, ndodhen godina banimi, lokale, dyqane. Akses i pronës është i mirë nga rruga hyrëse e fshatit. Infrastruktura dhe rrugët janë në gjëndje të mirë.

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Prona, objekt i këtij vlerësimi, ndodhet në rrugën e Limunthit.

Aktiviteti i Zyrës Postare Kashar kryhet në katin përdhe të një ndërtese 1-katëshe, me sipërfaqe

78.3 m², e cila nga brenda përbehet nga ambientet e shërbimit të klientit, një zyrë dhe korridori. Objekti ka strukturë me muraturë tulle të plotë dhe suvatuar dhe lyer me ngjyrat e postës. Soleta e betonit e objektit është e dëmtuar dhe me lagështirë. Muret kanë shenja lagështie të theksuar si jashtë ashtu dhe brenda. Dyshemeja është shtruar me pllaka porcelani. Objekti ka dritare te vogla me kasa duralumini. Në fasadën e jashtme ballore të kësaj zyre postare (mbi derë) është vendosur reklama e Zyrës Postare si dhe një kuti postare e madhe të cilat janë të dëmtuara.

FILIALI DURRËS

1. ZYRA POSTARE DURRESI NR.2

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Zyra Postare ndodhet në katin përdhe të një godine banimi dhe shërbimi egzistuese. Godina në të cilën ndodhet prona pozicionohet në anën veriore të qendrës së qytetit të Durrësit rreth 1.2 km larg në vijë ajrore.

Në anën veriore të pronës në akses të drejtperdrejtë me të kalon rruga “Kristo Sotiri” dhe në vazhdim ndodhen ndertesa të ndryshme banimi e shërbimesh. Në anën jugore të pronës ndodhet një tjetër ndërtesë egzistuese banimi dhe shërbimi dhe rreth 300 m larg në vijë ajrore ndodhet godina e Rajonit të Policisë. Në anën lindore të pronës ndodhen ndërtesa të ndryshme banimi e shërbimesh dhe rreth 250 m larg në vijë ajrore ndodhet zona e Stadiumit “Niko Dovana”. Në anën perëndimore të pronës në akses të drejtperdrejtë me të kalon rruga “Aleksandër Goga” dhe më tej ndodhet zona e Spitalit Rajonal të Durrësit.

Akses i mirë direkt nga rruga “A.Goga” dhe rruga “Kristo Sotiri”.

Infrastrukturë dhe rrugë në gjëndje të mirë mirëmbajtjeje e pajisur me ndriçim rrugor, trotuare të shtruara me pllaka betoni, zonë me trafik te mire automobilistik ne te dy drejtimet;

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Prona, objekt i këtij vlerësimi ndodhet ne katin perdhe te një ndërtesë egzistuese banimi dhe shërbimi, e cila është ndërtuar rreth viteve 80’.

Ndërtesa ka konstruksion me kollona b/arme me mure me tullë të plotë me trashësi të mureve të jashtme dhe atyre të brendshme 25 cm, nën një mbulesë me soletë monolite të hidroizoluar. Fasada e ndërtesës në të cilën ndodhet prona është e suvatuar dhe e lyer , prona ndodhet në kushte dhe gjendje të mirë mirëmbajtjeje. Akses i direkt nga rruga publike “Aleksandër Goga”

Prona ishte e rikonstruktuar vitet e fundit dhe paraqitej në kushte dhe gjendje relativisht të mirë. Sipërfaqja e brendshme e tije përbëhet nga ambjent i cili shërben për pritjen dhe shërbimin e klientëve, katër ambiente zyrash dhe tualeti. Hyrja në ambjente bëhet direkt nga sheshi kryesor nëpërmjet një porte me profile duralumini dhe xhama dhe nëpërmjet disa shkallëve të brendshme. Vettratat nga hyrja kryesore janë të mbrojtura edhe me qepen e grila metalike. Dyert e ambjenteve të brendshme janë me profile duralumini. Dritaret janë me profile duralumini dhe të mbrojtura me grila metalike. Dyshemeja në të gjitha ambientet është e shtruar me pllaka gres njëngjyrëshe, ndërsa janë vendosur edhe plintuesa përgjatë perimetrit të mureve. Tualeti është shtruar me pllaka gres, muret e tij janë të veshura me pllaka majolike në lartësi, si dhe është i paisur me lavaman e ëc. Instalimet elektrike janë brenda murit më vehte për

celësa e priza.

Objekti është rikonstruktuar 10 vitet e fundit, por për momentin ndodhet në kushte jo të mira për arsye të tërmetit të ndodhur në 26 nëntor 2019. Objekti ka krisje murrature dhe suvaje brenda dhe jashtë. Po ashtu, dyshemeja ka thyerje pllakash dhe plintuesish.

2. ZYRA POSTARE DURRESI NR.3

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona objekt vlerësimi nga ana jonë ndodhet në katin e dytë të një godine të re banimi e shërbimesh. Godina në të cilën ndodhet prona pozicionohet në anën veriore të qendrës së qytetit të Durrësit rreth 800 m larg në vijë ajrore.

Në anën veriore të pronës ndodhen ndërtesa të ndryshme banimi dhe shërbimi dhe rreth 100 m larg në vijë ajrore kalon rruga “Andon Naçi”.

Në anën jugore të pronës rreth 20 m larg kalon rruga e “Dëshmorëve”. Në anën juglindore të pronës rreth 120 m larg në vijë ajrore ndodhet godina e shkollës “Migjeni”. Në anën lindore të pronës ndodhen ndërtesa banimi dhe shërbimi, rreth 260 m larg në vijë ajrore kalon rruga “Mujo Ulqinaku” dhe në vazhdim ndodhet Pallati i Sportit. Në anën perëndimore të pronës rreth 50 m larg në vijë ajrore kalon rruga “Shoqëria Bashkimi”, dhe rreth 250 m larg në vijë ajrore ndodhet godina e Muzeut të Dëshmorëve. Prona aksesohet me rrugën “Dëshmorët”, nëpërmjet një rrugice që kalon në anën e pasme të saj.

Zona në të cilën ndodhet prona paraqitet me Infrastruktura dhe rrugë në gjendje të mirë mirëmbajtjeje e pajisur me ndriçim rrugor, trotuare të shtruara me pllaka betoni, zonë me trafik të mirë automobilistik në të dy drejtimet

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Zyra Postare ndodhet në katin e dytë të një ndërtese shumëkateshe banimi dhe shërbimi të ndërtuar vitet e fundit, nga e cila “Posta” shpallur ka hipotekuar një sipërfaqe truallë prej 128.8 m² dhe sipërfaqe ndërtimore prej 128.8 m².

Ndërtesa ka konstruksion me kollona betonarme me mure me tullë, nën një mbulesë me soletë monolite të hidroizoluara. Fasada e ndërtesës në të cilën ndodhet prona është e suvatur dhe e lyer, prona ndodhet në kushte dhe gjendje të mirë mirëmbajtjeje Prona paraqitet në kushte dhe gjendje shumë të mirë mirëmbajtjeje, me rifinitura bashkëkohore. Sipërfaqja e brendshme e pronës përbëhet nga ambjent i cili shërben për pritjen dhe

shërbimin e klientëve, si dhe ambjente të tjera pune, zyra e tualet. Hyrja në ambjentet e pronës, bëhet nga sheshi i brendshëm i pallatit nëpërmjet një porte me profile duralumini dhe xhama. Vetratat nga hyrja kryesore janë të mbrojtura edhe me qepen metalik. Dyert e ambjenteve të brendshme janë me profile duralumini. Dritaret janë me profile duralumini dhe nga ana e brendshme kanë të vendosura grila metal-plastike. Dyshemeja në të gjitha ambjentet është e shtruar me pllaka gres njëngjyreshe, me përjashtim të ambjentit të pritjes, ku një pjesë e vogël në formë kuadrati, janë me ngjyrë blu, ndërsa janë vendosur edhe plintues përgjatë perimetrit të mureve. Tualeti është shtruar me pllaka gres, muret e tij janë të veshura me pllaka majolike në lartësi, si dhe është i pajisur me lavaman e vc. Instalimet elektrike janë brenda murit më vehte për celësa e priza.

Objekti është rikonstruktuar 10 vitet e fundit, por për momentin ndodhet në kushte jo të mira për arsye të tërmetit të ndodhur në 26 nëntor 2019. Objekti ka krisje murrature dhe suvaje brenda dhe jashtë. Po ashtu, dyshemeja ka thyerje pllakash dhe plintuesish.

3. ZYRA POSTARE DURRESI NR.4

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Zyra Postare Durrës Nr. 4, ndodhet në një godinë banimi dhe shërbimi egzistuese. Godina në të cilën ndodhet prona pozicionohet në anën veriore të qendrës së qytetit të Durrësit rreth 1.2km larg në vijë ajrore. Në anën veriore të pronës, me akses të drejtëpërdrejtë me të, kalon rruga “Kristo Sotiri” dhe në vazhdim ndodhen ndërtesa të ndryshme banimi e shërbimesh. Në anën jugore të pronës, ndodhet një tjetër ndërtesë ekzistuese banimi dhe shërbimi. Për rreth 300m larg ndodhet godina e Rajonit të Policisë, Durrës. Në anën lindore të pronës ndodhen ndërtesa të ndryshme banimi e shërbimesh. Në anën perëndimore të pronës me akses të drejtëpërdrejtë me të, kalon rruga “Aleksander Goga” dhe me tej ndodhet zona e spitalit rajonal të qytetit të Durrësit. Infrastrukura dhe rruga janë në gjendje të mirë, e mirëmbajtur dhe e pajisur me ndriçim rrugor, trotuare të shtruara me pllaka betoni.

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Momentalisht ndërtesa ka konstruksion me kollona b/arme me murre me tullë, nën një mbulesë me solete monolite të hidroizoluar. Fasada e ndërtesës në të cilin ndodhet prona është e suvatuar dhe e lyster.

Objekti është rikonstruktuar 10 vitet e fundit, por për momentin ndodhet në kushte jo të mira për arsye të tërmetit të ndodhur në 26 nëntor 2019. Objekti ka krisje murrature dhe suvaje brenda dhe jashtë. Po ashtu, dysHEMEJA ka thyerje pllakash dhe plintuesish.

4. ZYRA POSTARE MANZË

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona ndodhet në fshatin Manzë, të rrethit të Durrësit, rreth 17 km larg në vijë ajrore në anën veri-lindore të qytetit të Durrësit. Në anën veriore të pronës, ndodhen ndërtesa kryesisht banimi dhe në vazhdim sipërfaqe të lira tokash are. Në jug të pronës në akses të drejtëpërdrejtë me të, kalon rruga kryesore e zonës, në vazhdim ndodhen shtëpi private banimi si dhe sipërfaqe të lira tokash arë. Në anën lindore të pronës ndodhen ndërtesa të ndryshme banimi dhe shërbimi. Për rreth 200 m larg në vijë ajrore, kalon rrugë e shtruar e zonës dhe në vazhdim ndodhen shtëpi të fshatit. Në perëndim të pronës, ndodhen ndërtesa të ndryshme dhe në vazhdim sipërfaqe të lira tokash are. Objekti ka akses direkt nga rruga kryesore e zonës, e cila është rrugë e asfaltuar.

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Zyra Postare ndodhet në një ndërtesë 1-katëshe dhe ka një sipërfaqe trualli 64.8 m² dhe sipërfaqe ndërtimore 34.6 m². Ndërtesa ka konstruksion me kollona b/arme me mure me tullë, mbuluar me soletë monolite. Fasada e ndërtesës në të cilën ndodhet prona, është e suvatuar dhe e lyster. Prona ndodhet në kushte dhe gjendje jo shumë të mirëmbajtur. Prona është e rikonstruktuar në 10 vitet e fundit por paraqitet në kushte dhe gjendje jo të mirë. Sipërfaqja e brendshme e pronës përbëhet nga një ambjent, i cili shërben për pritjen dhe shërbimin e klientëve, parabanja dhe tualeti. Hyrja në ambiente bëhet direkt nga rruga kryesore nëpërmjet një porte me profile duralumini dhe xhama. Vetratat nga hyrja kryesore janë të mbrojtura edhe me grila metalike. Dyert e ambienteve të brendshme dhe dritaret janë me profile duralumini por të dëmtuara.

Dyshemeja në të gjithë sipërfaqen është e shtruar me pllaka gres dhe me plintusa përgjatë perimetrit të mureve por gjatë viteve janë konsumuar duke i ikur ngjyra e pllakave dhe një pjesë e tyre janë të thyera. Tualeti është i shtruar me pllaka gres dhe muret e tij janë të veshura me pllaka majolike. Instalimet elektrike kanë nevojë për ndryshime pasi koha kur janë bërë është relativisht e madhe dhe shikohet e nevojshme të ketë ndryshime linjash elektrike dhe prizash, për të qenë sa me funksionale.

5. ZYRA POSTARE FUSHE-KRUJË

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Zyra Postare Fushë Krujë, ndodhet në qytetin e Fushë Krujës në qendër të qytetit, në katin e parë të një ndërtesë dy katëshe.

Aty ndodhen qendra rezidenciale me blloqe pallatesh 3-4 katëshe, institucionale si dhe ambjente tregtare dhe shërbimi. Në veri të objektit ndodhet qendra e qytetit, në jug ka pallate banimi dhe disa njësi shërbimi, në lindje dyqane, lokale, pallate banimi 3-4 kate dhe në perëndim kufizohet me godinën e Albtelekom. Objekti kufizohet në veri me pronën me numër pasurie 2/20, në lindje me pronën me numër pasurie 2/31, në jug me pronën me numër pasurie 2/29 dhe në perëndim me pronën me numër pasurie 2/29.

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Prona gjendet në anën veriore të rrethrotullimit në rrugën “Fushë Krujë - Krujë”. Prona është e vendosur në katin e parë të një ndërtese 2 katëshe. Ka strukturë me kollona dhe muraturë tulle. Katet ndahen nga njeri-tjetri me solete betoni. Muret e jashtme janë të lyera dhe të suvatuara dhe kanë vetëm probleme pasi janë të plasaritura dhe kanë shenja të theksuara lagështire. Hyrja kryesore është e pajisur me qepen nga jashtë. Pjesa e brendshme e godinës është e rikonstruktuar në 10-15 vjetët e fundit dhe e gjithë infrastruktura e brendshme (elektrik, hidraulik, shtrim pllakash, dyer, dritare, etj) është e vjetër. Sportelet janë të punuara me vetratë duralumini dhe xhami. Dyshemeja është e shtruar me pllaka të vjetra porcelani me disa shenja thyerje dhe plasaritje.

6. ZYRA POSTARE KRUJË QENDËR

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Zyra Postare ndodhet në qytetin e Krujës. Kruja përfshihet në prefekturën e Durrësit. Kufizohet me qytetin e Tiranës rreth 19.57 km prej saj në pjesën jugore, në pjesën veriore me Mamurrasin, në pjesën verilindore me Burrelin dhe në pjesën perëndimore me Durrësin. Popullsia është rreth 19.400 banorë. Zyra Postare Krujë, Qendër, ndodhet në pjesën qendrore të qytetit të Krujës në Rr.”Vrana Konti”, në katin e dytë të një godine 4-katëshe, sipër zyrave të Albtelecom. Ajo është një zonë qendrore me përdorim kryesisht rezidencial me shtëpi një dhe dy katëshe, pallate 5-katëshe dhe ndërtesa publike. Objekti ka akses shumë të mirë, nga rruga kryesore. Kufizimet e pronës janë në veri me pallate banimi, në jug me hotele dhe pallate banimi, në lindje rrugë kryesore me asfalt, në perëndim kufizohet me shtëpinë e kulturës që ndodhet në qendër të qytetit.

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Zyra Postare Krujë, Qendër, ndodhet në katin e parë të një godine 4-katëshe, ndërtesë e stilit të

viteve 80-të. Në pjesën e jashtme godina është e rikonstruktuar, e mirëmbajtur, e suvatuar dhe e lyer me bojë, me vatrata xhami. Shkallët janë të veshura me pllaka dhe të mbuluara me profile. Aksesit për në pronë shumë i mirë, pasi realizohet në mënyrë të drejtpërdrejtë me rrugën kryesor. Ambienti i shërbimit është i ndarë në dy ambjente të veçanta me një banak në formë L-je. Si banak shërben një mur i veshur me pllaka mermeri dhe ndarëse me profile duralumin me xham në lartësi. Ambjentet e shërbimit janë të ndara gjithashtu me mur të suvatuar e lyer deri në lartësinë prej 1.2 m, e mandej në lartësi deri në tavan, janë të vendosura profile duralumini me xham. Sportelet e shërbimit kanë në lartësi gjithashtu vetrata duralumini dhe xhami. Pjesa e poshtme e tyre është e veshur me pllakë mermeri. Muret janë të suvatuara dhe të lyera me bojë. Dyshemeja është e shtruar me pllaka gres. Tualeti është i shtruar me pllaka dhe muret janë të veshura me pllaka majolike. Në momentin e investigimit tualeti ishte funksional dhe me paisjet hidrosanitare si lavaman e ëc, por me probleme të theksuara lagështire. Dyert janë prej druri dhe profile duralumini me xham.

FILIALI ELBASAN

1. ZYRA POSTARE LUNIK-LIBRAZHD

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Zyra Postare ndodhet në fshatin Lunik të rrethit Librazhd, rreth 10 km larg në veri të qytetit të Librazhdit. Në anën veriore të pronës ndodhet shesh i lirë dhe me tej është godina e Ndërmarrjes Pyjore, kurse në anën jugore të pronës ndodhen sipërfaqe të lira tokash arë si dhe rreth 50 m është godina e ish dyqanit (banesë). Në anën lindore të zyrës postare fillon lartësia e kodrës, ku ndodhen sipërfaqe të lira tokash arë si dhe kullota. Në anën perëndimore të pronës kalon një rrugë automobilistike dytësore, është një pemtore dhe rreth 60 m kalon rruga Librazhd-Streblevë. Zona është kryesisht zonë banimi. Infrastruktura e saj është normale, por ka nevojë edhe për përmirësim.

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Zyra Postare ndodhet në katin e parë të godinës 4-katëshe, ndërtesë e stilit të viteve 80-të. Në pjesën e jashtme godina është e rikonstruktuar, e mirëmbajtur, e suvatuar dhe e lyer me bojë, me vatrata xhami. Shkallët janë të veshura me pllaka dhe të mbuluara me profile. Aksesit për në pronë shumë i mirë, pasi realizohet në mënyrë të drejtpërdrejtë me rrugën kryesor. Pjesa e brendshme e godinës është e amortizuar. Ambienti i shërbimit është i ndarë në dy ambjente të veçanta me një banak në formë L-je. Si banak shërben një mur i veshur me pllaka mermeri dhe ndarëse me profile duralumin me xham në lartësi. Ambjentet e shërbimit janë të ndara gjithashtu me mur të suvatuar e lyer deri në lartësinë prej 1.2 m, e mandej në lartësi deri në tavan, janë të vendosura profile duralumini me xham. Sportelet e shërbimit kanë në lartësi gjithashtu vetrata duralumini dhe xhami. Pjesa e poshtme e tyre është e veshur me pllakë mermeri. Muret janë të suvatuara dhe të lyera me bojë. Dyshemeja është e shtruar me pllaka gres por një pjesë e tyre janë të dëmtuara dhe të kosumuara. Tualeti është i shtruar me pllaka dhe muret janë të veshura me pllaka majolike. Në momentin e investigimit tualeti ishte funksional dhe me paisjet hidrosanitare si lavaman e vc. Dyert janë prej druri dhe profile duralumini me xham.

2. ZYRA POSTARE ZDRAJSH-VERRI-LIBRAZHD

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona ndodhet në fshatin Zdrajsh të rrethit Librazhd, rreth 13 km larg në jug-lindje të qytetit të Librazhdit, në aksin e rrugës Funar-Orenjë. Në anën veriore të pronës, në akses të drejtëpërdrejtë me të, kalon rruga kryesore e fshatit Zdrajsh dhe në vazhdim ndodhen siperfaqe të lira tokash arë bujqësore. Në anën jugore të pronës ndodhet ndërtesë një katëshe shërbimi dhe në vazhdim ndodhen siperfaqe tokash bujqësore si dhe shtëpi të fshatit Zdrajsh. Në anën lindore të pronës ndodhen shtëpi e sipërfaqe tokash arë dhe në anën perëndimore të pronës, rreth 60 m janë magazina dhe shtëpi.

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Dy pronat, posta dhe ish banka e kursimeve, janë në një ndërtesë të vetme, ku ambientet e postës janë në anën perëndimore të saj. Godina është një ndërtesë një katëshe me konstruksion beton arme, mure tulle, mbuluar me solete monolite beton arme. Ndërtesa nga jashtë është e pa suvatuar dhe e pa lyer. Rifiniturat e brendshme të saj nuk janë në gjendje të mirë dhe kanë nevojë për rikonstruksion. Objekti i ish bankës vazhdon të funksionojë si zyrë postare, kurse objekti i postës është jashtë funksionimit si i tillë, pasi është duke e përdorur pronari i truallit si lokal. Ish posta ka një sipërfaqe ndertimore prej 40 m². Prona është e përbërë nga katër ambiente, ku dy prej tyre funksionojnë si lokal, kusre dy ambiente të tjera janë bosh dhe të amortizuar në gjithë rifiniturat. Ambientet e brendshme të pronës janë në gjendje të amortizuar. Dyshemetë janë të shtruara me pllaka çimento, pjesërisht të dëmtuara. Muret dhe tavanet janë të suvatuara dhe të lyera. Vetratat e dritareve janë me kasa druri me xham. Ato janë të mbrojtura me shufra hekuri. Hyrja në këtë ambient realizohet nga ana perëndimore me derë druri dhe nga ana veriore, nëpërmjet një shtese që ka bërë pronari i truallit, me një derë metalike. Ish ambientet e bankës janë duke funksionuar si zyrë postare. Ato përbëhen nga dy ambiente. Hyrja në to realizohet nga ana veriore, me portë druri të vjetër dy kanatëshe. Porta ka edhe zgarë metalike mbrojtëse dhe lidhet në anën veriore me aksin e rrugës kryesore të fshatit. Ambientet janë të shtruara me pllaka betoni, pjesërisht të amortizuara. Muret dhe tavanet janë të suvatuar, por në gjendje jo shumë të mirë. Dritaret janë me kasa druri të vjetra dhe me zgara metalike. Furnizimi me energji elektrike dhe ujë realizohet nga rrjetet përkatëse të zonës. Instalimet janë të amortizuara.

3. ZYRA POSTARE FARRET-LIBRAZHD

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona ndodhet në fshatin Farret të rrethit Librazhd, rreth 23 km larg në jug-lindje të qytetit të Librazhdit dhe rreth 6 km në perëndim të aksit të rrugës Qukës-Qafë Pllocë. Në anën veriore të pronës ndodhen ndërtesa banimi, në vazhdim kalon rrugicë e pashtuar e fshatit dhe më tej theksohet pjerrësia e kodres. Në anën jugore të pronës kalon rruga kryesore e fshatit që shkon drejt Stravaj, rreth 50 m larg është qendra administrative, rreth 70 m është qendra shëndetësore dhe rreth 130 m është Shkolla 9 vjecare. Në anën perëndimore të pronës ndodhet ndërtesë një katëshe banimi, në vazhdim ndodhen siperfaqe tokash arë bujqësore dhe më tej kalon rruga kryesore e fshatit. E parë nga lart zona ka një ndërthurje, shtëpish banimi e toka bujqësore. Zona është kryesisht zonë banimi. Infrastruktura e saj ka nevojë edhe për përmirësim.

B-PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Godina në të cilën ndodhet prona është një ndërtesë një katëshe, me konstruksion beton arme, mure tulle, mbuluar me solete monolite beton arme. Ajo momentalisht nuk funksionon si zyrë postare. Ndërtesa nga jashtë është e suvatuar dhe e lyer, por në gjendje të amortizuar. Rifiniturat e brendshme të saj nuk janë në gjendje të mirë dhe kanë nevojë për rikonstruksion. Hyrja në të realizohet nga ana lindore, nëpërmjet një verande të mbuluar, me lidhje me sheshin dhe rrugën. Prona ka një sipërfaqe prej 30 m² truall dhe 20 m² ndërtim. Prona është e përbërë nga ambjenti i shërbimit të klientëve, si dhe ambjente zyra ndihmëse, një tualet dhe veranda. Ambientet e brendshme të pronës janë në gjendje të amortizuar. Dyshemetë janë të shtruara me pllaka çimento. Muret dhe tavanet janë të suvatuara dhe të lyera, por të dëmtuar. Vetratat e dritareve janë me kasa druri me xham, të vjetra dhe me zgara metalike. Dera kryesore është dy kanatëshe druri e vjetër, kurse dyert e brendshme janë druri të amortizuara. Tualeti është i parregulluar. Instalimet elektrike dhe të ujit janë të dëmtuara dhe jashtë funksionit.

4. ZYRA POSTARE MLIZË

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona ndodhet në Fshatin Mlizë, rreth 60 km në jug-lindje të Tiranës, 14 km nga qyteti i Elbasanit. Prona ndodhet në qendër të fshatit, në distancë rreth 190 m në vijë ajrore në jug të rrugës Elbasan- Mlizë. Në veri prona me ndërtesa kryesisht banimi 1 katëshe dhe toka të lira. Më në veri ndodhet fshati Hajdaraj. Në jug prona kufizohet me ndërtesa 1 katëshe banimi dhe në distancë rreth 800 m shtrihen kodra të ulta. Në lindje prona kufizohet me një shesh të lirë dhe me një kryqëzim rrugësh të fshatit. Më në lindje në distancë rreth 600 m në vijë ajrore kalon rruga Hajdaraj - Mlizë. Në perëndim prona kufizohet me banesa 1-2 katëshe dhe më në perëndim në distancë rreth 1.3 km ndodhet fshati Vreshtas. Zonë tërësisht rurale bën pjesë në Njësinë Administrative të Shushicës, të rrethit të Elbasanit. Kjo komunë përfshin fshatrat Shushicë, Shelcan, Mlizë, Hajdaran, Fush-Bull, Vasjan, Polis i Vogël, Polis Vale, Vreshtaj. Ndërtesat janë kryesisht 1-2 katëshe. Rrugët e fshatit janë të shtruara pjesërisht me asfalt e pjesërisht me cakëll.

B-PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Prona është rikonstruktuar vitet e fundit dhe paraqitet në gjendje dhe kushte të mira mirëmbajtjeje. Hyrja kryesore realizohet nëpërmjet shkallëve me bazamak mermeri dhe shesh pushimi me pllakë gres. Fasada e jashtme është e suvatuar dhe e lyer, pak e amortizuar, për shkak edhe të disa shenjave të lagështirës kryesisht në pjesën e poshtme të murit. Sipërfaqja e truallit e rrethuar me zgara metalike dhe hyrja për në, të realizohet nëpërmjet një porte tip zgare metalike me kasë me profile metalike. Aksesit për në pronë i mirë, pasi realizohet nëpërmjet sheshit të ndërtesës, e mandej nëpërmjet tre shkallëve zbritëse, me trotuarin e rrugës kryesore të zonës. Nga brenda përbëhet nga 1 ambjent shërbimi dhe 3 ambjente ndihmëse, korridor e 1 tualet. Ambjenti i shërbimit për klientët është i ndarë me një banak druri. Hyrja kryesore realizohet nëpërmjet shkallëve me bazamak mermeri dhe shesh pushimi me pllakë gresi. Dera hyrëse dhe dyert e brendshme, dera e tualetit dhe dritaret, janë me profile duralumini dhe me xhama. Dera e jashtme e mbrojtur me qepen metalik, ndërsa dritaret me zgara metalike. Shtrimi i ambjenteve të brendshme është bërë me pllaka gres dhe plintusa përreth, muret dhe tavanët janë të suvatuar dhe të lyer, me pak shenja lagështie. Tualeti është i kompletuar me vc dhe

lavaman.

5. ZYRA POSTARE SHALËS

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona ndodhet në Fshatin Shalës në jug të Tiranës, 20 km nga qyteti i Elbasanit dhe rreth 4 km nga qyteti i Cerrikut. Prona ndodhet pranë Rrugës Cerrik Shalës dhe rrugës kryesore të fshatit. Në veri prona kufizohet me ndërtesa 1-2 katëshe dhe më në veri në distancë rreth 300 m fillon terren kodrinor. Në veri-perëndim në distancë rreth 1.6 km ndodhet ujmbledhesi

i Ulzës. Në lindje prona kufizohet me ndërtesa 2 katëshe shkollae Fshatit , më tej në distancë rreth 5.2 km në vijë ajrore gjendet zona e Gostimës. Në jug prona kufizohet me një ndërtesë 1 kateshë dhe më tej kalon një rrugë e fshatit. Në perëndim prona kufizohet me një shesh të lirë dhe me rrugën kryesore të fshatit. Zonë tërësisht rurale në Komunën e Shalësit të rrethit të Elbasanit. Kjo komunë përfshin fshatrat Shalës · Liçaj · Kurtali · Xibrakë · Xherije · Kodras. Ndërtesat janë kryesisht 1-2 katëshe. Rrugët e fshatit janë të shtruar me cakëll.

B-PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Prona është një ndërtesë me 1 kt mbi tokë, ndërtuar në vitin 1984. Ndërtesa ka konstrukcion me themele betoni, mure masive perimetrale tullë me trashësi të mureve të jashtme 25 cm, kollona betoni mbajtëse, mbuluar cati me tjegulla. Fasada e jashtme është e suvatuar dhe e lyer, në gjendje të mirë mirëmbajtjeje. Prona është rikonstruktuar rreth dhjetëvjeçarit të fundit dhe paraqitet në gjendje dhe kushte relativisht të mira mirëmbajtjeje. Nga brenda përbëhet nga 1 ambjent shërbimi dhe 3 ambjente ndihmese, korridor e 1 tualet. Hyrja kryesore realizohet nëpërmjet shkallëve me bazamak mermeri dhe shesh pushimi me pllakë gresi. Dera hyrëse dhe dyert e brëndshme dyert e tualeteve dhe dritaret janë me profile duralumini dhe xham. Dera hyrëse është e mbrojtur me qepen metalik, ndërsa dritaret me zgara hekuri. Shtrimi i ambjenteve është me pllakë gresi dhe plintusa përreth, muret dhe tavanët janë të suvatuar dhe të lyera. Tualeti është i kompletuara me vc dhe lavaman.

6. ZYRA POSTARE GOSTIMË

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona ndodhet në Fshatin Gostimë në jug të Tiranës, 22 km nga qyteti i Elbasanit dhe rreth 5.3 km nga qyteti i Cerrikut. Prona ndodhet pranë qendrës së fshatit Gostimë dhe pranë rrugës kryesore të fshatit. Në veri prona kufizohet me ndërtesa 1-2 katëshe dhe më në veri në distancë rreth 320 m ndodhet shkolla 9-vjecare e fshatit Gostimë. Në veri-perëndim në distancë rreth 1.6 km ndodhet ujmbledhesi i Ulzës. Në lindje prona kufizohet me ndërtesa 1 katëshe, më tej në distancë rreth 800 m në vijë ajrore, gjendet kodra e Qamishtës. Në jug prona kufizohet me një ndërtesë 1 kateshë dhe më tej në distancë rreth 180 m kalon rruga Cërrik Gramsh. Në perëndim prona kufizohet me një shesh të lirë dhe me rrugën kryesore. Më në perëndim gjenden shtëpi 1-2 katëshe dhe më në perëndim në distancë rreth 1.9 km gjendet Kompleksi Arsimorë iranian. Zonë tërësisht rurale në Komunën e Gostimës të rrethit të Elbasanit. Kjo komunë përfshin fshatrat Çartallozi- Gostima-Gjyrali- Malaseji- Shtepanji-Shtërmëni - Shushica. Ndërtesat janë kryesisht 1-2 katëshe. Rrugët e fshatit janë të shtruar

kryesisht me asfalt.

B-PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Prona është një ndërtesë me 1 kt mbi tokë në formë L-je, ndërtuar në vitin 1986. Ndërtesa ka konstruksion me themele betoni, mure masive perimetrale tullë me trashësi të mureve të jashtme 25 cm, kollona betoni mbajtëse, mbuluar soletë betonarme. Fasada e jashtme është e suvatuar dhe e lyster, në gjendje të mirë mirëmbajtjeje. Një pjesë e godinës, është dhënë me qera kohët e fundit tek një subjekt që ushtron veprimtari si agjensi udhëtimesh për jashtë shtetit. Prona është rikonstruktuar dhjetëvjeçarin e fundit dhe paraqitet në gjendje dhe kushte të mira mirëmbajtjeje. Nga brenda përbëhet nga 1 ambjent shërbimi dhe 2 ambjente ndihmëse, korridor e 1 tualet. Hyrja kryesore realizohet nëpërmjet shkallëve me bazamak mermeri dhe shesh pushimi me pllakë gresi. Dera hyrëse dhe dyert e brëndshme, dera e tualetit dhe dritaret, janë me profile duralumini, shtrimi i ambjenteve është me pllakë gresi dhe plintusa përreth, muret dhe tavanët janë të suvatuar dhe të lyster. Tualeti është i kompletuar me vc dhe lavaman.

FILIALI FIER

1. ZYRA POSTARE QENDER-MALLAKASTER

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Zyra Postare ndodhet në qytetin e Ballshit, të rrethit të Mallakastër, 136 km në jug të Tiranës dhe 23 km në jug të Fierit. Zyra Postare ndodhet në qendër të qytetit dhe përgjatë rrugës kryesore, zonë urbane ekonomikisht jo e qëndrueshme, e një niveli ekonomik stabil nënmesatar, me përdorim miks rezidencial, tregtare dhe insitucionale; Në veri ndërtesa dy dhe tre katëshe. Në jug rrugë dhe më tej ndërtesë 4-katëshe; Në lindje pallate 5-katëshe. Në perëndim rruga kryesore “Blv.Rrapo Hekali” dhe më tej ndërtesa 2 dhe tre katëshe. Akses shumë i mirë nga rruga kryesore “Blv.Rrapo Hekali”. Infrastrukturë dhe rrugë kryesore në gjendje të mirë mirëmbajtjeje e pajisur me ndriçim rrugor, trotuare të shtruara me pllaka betoni;

B-PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Zyrë postare me sip. 22.5 m2, ndodhur në katin e parë të një ndërtese pesë katëshe të ndërtuar rreth vitit 80'. Ndërtesa në të cilën ndodhet prona ka konstruksion themele guri, mure tulle të plotë, mbulesë soletë monolite. Fasada e jashtme e ndërtesës është e pa suvatuar dhe e lyster me gëlqere. Godina në të cilën ndodhet prona ka akses të drejtpërdrejt nga rruga publike.

Prona është zyra nr.1 postare në qytetin e Ballshit. Prona paraqitet në përgjithësi në gjendje dhe kushte mesatare. Muret janë të suvatuar dhe të lyster, në gjendje normale, dysHEMEJA është e shtruar me pllaka gres. Prona është e përbërë nga ambienti i sportelit të shërbimit + ambient ndihmës. Ambienti sportelit me sallën e klientëve, është i ndarë me një banak druri, ku në lartësi të të cilit ka vetrata druri me xham. Vetrata e hyrjes është me profile duralumini dhe e pambrojtur me kangjella metalike.

Sipërfaqja e përgjithëshme ndërtimore e zyrës është 22.5 m2.

FILIALI VLORE

1. ZYRA POSTARE KUC

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Zyra Postare objekt vlerësimi janë zyrat e postës, të cilat ndodhen në fshatin Kuç, 160 km në jug të Tiranës, rreth 55 km në juglindje të qytetit të Vlorës.

Zyra Postare ndodhet në afërsi të qendrës, rreth 40 m, në anën jugore të sheshit qendror të fshatit Kuç, ku ndodhet edhe qendra shëndetësore dhe monumenti i Zenel Gjolekës. Në lindje të pronës, rreth 20 m, kalon rruga nacionale Kuç-Fterë dhe vazhdojnë shtëpi të fshatit. Zona ku ndodhet prona është kryesisht zonë rurale, me përdorim miks. Përreth tij ndodhen godina banimi, lokale shërbimi, dyqane. Akses i pronës është i mirë, direkt nga rruga nacionalet, dhe infrastruktura dhe rrugët janë në gjëndje jo shumë të mirë.

B-PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Zyra Postare është ish dega e Bankës, që ndodhen në Kuç. Sipas dokumentave që kemi dhe sqarimeve nga banorët, vërejmë se këto dy ndërtesa kanë qenë të lidhura me njera-tjetrën, ku dega e Bankës ka qenë në anën veriore të ambienteve të PTT. Të dy këto ndërtesa kanë një sipërfaqe ndërtimore të hipotekuar 85 m², ku PTT ka sipërfaqe 72 m² dhe dega e bankës 13 m², si dhe një truall 208 m².

Trualli ka sipërfaqe të rregullt dhe është në një teren me pjerrësi të vogël në drejtimin lindje-perëndim. Ai është i pasistemuar dhe pjesërisht i rrethuar me rjetë teli.

Gjatë investigimit vërejtëm se ndërtesa është e dëmtuar dhe pjesërisht e prishur, jashtë funksionit. Ajo është ndërtuar para viteve 1970 dhe ka themele guri, mure perimetralë tulle dhe guri, mbuluar me soletë të dëmtuar. Ana jugore e saj është prishur plotësisht.

Ndërtesa është e shkatërruar. Ka ngelur vetëm ambienti i një dhome, e cila është e mbuluar me soletë, me dritare druri të vjetër e zgarë hekuri, gjithashtu të gjitha të amortizuara. Dera e saj është nga na perëndimore, derë druri e amortizuar.

FILIALI LUSHNJE

1. ZYRA POSTARE BALLAGAT

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona objekt vlerësimi është zyra postare e cila ndodhet në fshatin Ballagat të Lushnjes, rreth 80 km në jug të qytetit të Tiranës dhe rreth 7 km larg nga qendra e qytetit të Lushnjes, në anën verilindore të saj. Prona subjekt i këtij vlerësimi ndodhet pranë zyrave të ish kooperativës dhe ka dalje në rrugë. Prona ndodhet në qendër të fshatit Ballagat dhe ka akses me rrugën kryesore të fshatit. Zona ku ndodhet prona është kryesisht zonë rurale, me nivel ekonomik të ulët, me shtëpi banimi 1 e 2 katëshe e dyqane të vogla buzë rrugës.

B-PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Prona është një njësi e cila sipas matjeve faktike në vend, rezulton me një sipërfaqe prej rreth 105

m², ndërsa sipas certifikatës për vërtetim pronësie, prona figuron me një sipërfaqe 180 m² ndërtesë. Prona ndodhet në një godinë 1-katëshe, ndërtuar rreth viteve 80', e rikonstruktuar pjesërisht pas viteve 2010, me konstruksion themele guri e mure tulle të plotë të kombinuar me breza betoni, e mbuluar me soletë monolite. Muret nga ana e fasadës janë të suvatuara e lyera, pjesërisht të amortizuara.

Në momentin e inspektimit konstatuam që ambjentet e sporteleve të shërbimit të klientit dhe një zyrë janë rikonstruktuar, ndërsa ambjentet e tjera ndihmëse dhe tualeti të parikonstruktuar.

Pjesa e pronës që është e rikonstruktuar pjesërisht rreth viteve 2005-2010, paraqitet në përgjithësi në gjendje dhe kushte të mira mirëmbajtjeje. Prona është e përbërë nga ambientet e sporteleve të shërbimit, ambientet e zyrave dhe ambiente ndihmëse.

Ambientet e brendshme të pronës me përjashtim të ambjenteve ndihmëse, janë me rifinitura normale, me dysheme të shtruara me pllaka gresi dhe të pajisur me plintuesa anësor përgjatë mureve. Muret dhe tavanet janë të suvatuara dhe të lyera, me pak prani lagështie, ndërsa muret dhe tavanet e ambjenteve ndihmëse janë në gjendje të amortizuar. Tualeti i amortizuar dhe jofunksional.

Vetratat e dritareve dhe dyerve janë me profile duralumini me xham. Ato janë të mbrojtura me qepena e kangjella metalike.

Vetratat e dritareve të ambjenteve të parikonstruktura, janë me profile druri me xham, ndërsa dyert me material druri.

2. ZYRA POSTARE GOLEM

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona objekt vlerësimi është zyra postare e cila ndodhet në fshatin Golem i Madh të Lushnjës, rreth 80 km në jug të qytetit të Tiranës dhe rreth 6 km larg nga qendra e qytetit të Lushnjës, në anën veriore të saj. Prona objekt i këtij vlerësimi ndodhet pranë zyrave të ish kooperativës dhe ka dalje në rrugë. Prona ndodhet në qendër të fshatit Golem i Madh dhe ka akses me rrugën kryesore të fshatit. Zona ku ndodhet prona është kryesisht zonë rurale, me nivel ekonomik të ulët, me shtëpi banimi 1 e 2 katëshe e dyqane të vogla buzë rrugës.

B-PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Prona është një njësi me sip. ndërtimore 110 m², e cila ndodhet në një godinë 1-katëshe, ndërtuar rreth viteve 80', me konstruksion themele guri e mure tulle të plotë të kombinuar me breza betoni, e mbuluar me soletë monolite. Muret nga ana e fasadës janë të suvatuara e lyera, por të amortizuara, ndërsa nga dy anët e tjera, të pasuvatuara dhe të palyera.

Godina është 1-katëshe ka katër ambiente që funksionojnë si zyra postare. Njeri nga ambientet funksionon me sportel për banorët. Disa nga zyrat ishin të boshatisura.

Ambientet e brendshme të pronës janë me rifinitura normale, me dysheme të shtruara me pllaka gresi dhe të pajisur me plintuesa anësor përgjatë mureve. Veshja e banakut të sportelit është realizuar me material druri. Muret dhe tavanet janë të suvatuara dhe të lyera, por disa ambiente janë me lagështirë dhe punimet e brendshme të amortizuara. Vetratat e dritareve nga ana e fasadës dhe dyerve janë me profile duralumini me xham, ndërsa të tjerat me profile druri e xham. Ato janë të mbrojtura me qepena e kangjella metalike.

3. ZYRA POSTARE TERBUF

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona objekt vlerësimi është zyra postare e cila ndodhet në fshatin Tërbuf të Lushnjës, rreth 97 km në jugperëndim të qytetit të Tiranës dhe rreth 18 km larg nga qendra e qytetit të Lushnjës, në anën jugore të saj.

Prona subjekt i këtij vlerësimi ndodhet rreth 3 km larg superstradës Durrës-Lushnje-Fier, në

anën jugore të saj.

Prona ndodhet buzë rrugës së fshatit, në një godinë 2-katëshe.

Zona ku ndodhet prona është kryesisht zonë rurale, me nivel ekonomik të ulët, me shtëpi banimi 1 e 2 katëshe e dyqane të vogla buzë rrugës.

B-PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Prona është një njësi me sip. ndërtimore 32 m2 dhe 20 m2 të cilat ndodhen në katin e parë të një godinë 2-katëshe, ndërtuar rreth viteve 80', me konstruksion themele guri e mure tulle të plotë të kombinuar me breza betoni, e mbuluar me soletë monolite. Një pjesë e godinës funksionon si zyra postare, ndërsa pjesa tjetër prej 20 m2, është e amortizuar dhe nuk është funksionale.

Ambientet e brendshme të pronës me sip. 32 m2, janë me rifinitura normale, me dysheme të shtruara me pllaka gresi dhe të pajisur me plintuesa anësor përgjatë mureve. Muret dhe tavanet janë të suvatuara dhe të lyera, por disa ambiente janë me lagështirë. Dyert dhe dritare janë duralimini, me qepen e kangjella metalike.

Prona me sipërfaqe 20 m2, aktualisht është e braktisur, bosh dhe tepër e amortizuar. Prona nga brenda përbëhet nga dy ambiente. Ka nevojë për riparim kapital: si suvatime të jashtme dhe të brendshme, shtresa e dyshemese, dyer dhe dritare. Aktualisht dyert dhe dritaret janë të amortizuara, por të mbrojtura me kangjella hekuri.

4. ZYRA E ADMINISTRATES LUSHNJE-KATI I-RE

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Posta qendrore ndodhet në qytetin e Lushnjes, 83 km në jug të Tiranës, rreth 300 m në jug të qendrës së qytetit, në lindje të bulevardit "Kongresi i Lushnjës" dhe në jug të Muzeut të qytetit.

Në veri prona kufizohet me rrugën hyrëse dhe godinën e Muzeut. Në jug ndodhet një pallat i rill-katësh dhe më tej objekte të ndryshme 4-5 katëshe ekzistuese dhe pallate të reja 7-10 katëshe.

Në perëndim të pronës kalon shëtitorja "Demokracia", ku prona ka akses të drejtpërdrejtë dhe më tej një lulishte.

Në lindje ndodhen garazhe, pallate 5-katëshe dhe rrugë të lagjes "Kongresi i Lushnjës".

Zona ku ndodhet prona është kryesisht zonë urbane qendrore, ekonomikisht me prosperitet dhe në rritje, të një niveli të mirë ekonomik, me përdorim miks. Përreth tij ndodhen objekte rezidenciale me pallate banimi, e zhvilluar edhe me shumë në këto vitet e fundit, me zyra, lokale shërbimi, dyqane dhe ndërtesa institucionale.

Akses i pronës është i mirë, direkt nga bulevardi kryesor nëpërmjet një rruge kryesore të qytetit.

Infrastruktura dhe rrugët janë në gjëndje të mirë, pajisur me ndriçim rrugor, trotuare të shtruara me pllaka betoni.

B-PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Prona, objekt i këtij vlerësimi, është kati përdhe dhe i parë i një ndërtese dy dhe kater katëshe me bodrum, tregtare, shërbimi/dyqan & zyra, operacionale, e ndërtuar në vitin 1988 dhe është rikonstruktuar në vitin 2001.

Ndërtesa ka konstruksion të kombinuar kollona, trarë dhe soleta b/arme me mur tulle me trashësi 25 cm dhe 12 cm për muret e jashtme e të brendshme. Kati bodrum i ndërtesës ka konstruksion mure, soletë dhe dysheme b/arme të hidroizoluar nga tre anë.

Arkitektura e jashtme e ndërtesës është tip e viteve të ndërtimit, në përshtatje me destinacionin e

objektit dhe të ndërtesave përreth të ndërtuara në vitet 70-80-të. Fasadat e jashtme janë trajtuar me elemente dekorative si kolloneta dhe korniza dekorative. Fasada e katit të parë është e veshur me travertinë dhe shkallët hyrëse të shtruara dhe të veshura me mermer, kurse në lartësi fasadat janë të suvatuara me granilim dhe të lyera. Dritaret dhe vetratat janë profile duralumini e xham dhe ato të katit përdhe të siguruara me zgara mbrojtëse e qepena metalik.

E gjithë ndërtesa është e ngritur mbi platformën e bodrumit. Ndërtesa ka hyrje kryesore me shkallë masive në anën perëndimore të saj për në katin përdhe, ku bëhen shërbimet me klientin dhe hyrje në anën veriore, e cila nëpërmjet shkallëve të brendshme realizon komunikimin midis kateve. Trotuari para pronës është i shtruar dhe i sistemuar, kurse trualli para saj është i sistemuar, i gjelbëruar dhe në të janë instaluar kabina telefonike. Aksesit në pronë është shumë i mirë, pasi hyrja realizohet direkt nga shëtitorja "Kongresi i Lushnjës".

Trualli me sipërfaqe 450 m² ka formë të shkallëzuar, brenda të cilit është ngritur ndërtesa. Sheshi para është i gjelbëruar dhe i rrethuar me kangjella. Hyrja realizohet nga ana veriore nëpërmjet një

porte metalike.

Kati i përdhe me sipërfaqe 449 m², nga brenda përbëhet nga ambientet e shërbimit të klientit, dy koridore, shkallët e brendshme dhe sheshpushimi, si dhe ambientet e zyrave e punonjësve. Ky kat është i rikonstruktuar pjesërisht dhe paraqitet në kushte dhe gjendje relativisht të mirë mirëmbajtje. Kështu dyshemetë e ambienteve janë pjesërisht të shtruara me pllaka gresi, pjesërisht me shtresat ekzistuese mozaik pllakash dhe pllaka granili. Muret dhe tavanet janë të suvatuara e të lyera.

Vetratat dhe dritaret janë profile duralumini me xham, kurse dyert e brendshme janë pjesërisht tamburato të rimesuara dhe të llakuara dhe pjesërisht duralumini me xham akulli. Shkallët në koridorin e pasmë janë të veshura me bazamakë mermeri dhe parapeti është mur i suvatur me korimano druri. Lartësia e katit është rreth 4 m.

Kati i parë ka sipërfaqe 150 m². Në këtë kat hyrja realizohet nga kafazi i shkallëve dhe përbëhet nga dhomat e zyrave, korridoret dhe grupi i tualeteve me parabanjë. Në ambientet e këtij kati janë vendosur ambientet e zyrave të postës dhe ambiente të tjera ndihmëse. Ky kat është rikonstruktuar dhe paraqitet në kushte dhe gjendje të mirë mirëmbajtje. Dyshemeja e të gjitha ambienteve është e shtruar me pllaka gresi. Muret dhe tavanet janë të suvatuara, patinuara dhe lyera. Dritaret janë me profile duralumini e xham me grila të brendshme. Vetratat ndarëse të ambienteve janë gjithashtu duralumini me xham. Dyert e brendshme janë profile duralumini me xham akulli. Lartësia e katit është rreth 3.4 m.

Tualetet janë të shtruara në dysheme me pllaka gresi dhe të veshura në mure me pllaka majolike. Ato janë të pajisura me paisje hidrosanitare porcelani si vc dhe lavaman.

FILIALI BERAT

1. ZYRA POSTARE VELABISHT (STAROVË)

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona objekt vlerësimi janë zyrat e postës, të cilat ndodhen në fshatin Starovë të Beratit, rreth 80 km në jug të Tiranës dhe rreth 4 km në veriperëndim të qytetit të Beratit. Prona ndodhet në qendër të Starovës, rreth 120 m në anën perëndimore të rrugës kryesore të zonës. Në lindje të saj janë shtëpi të fshatit, rreuga dhe rreth 1 km kalon lumi Osum, kurse në perëndim është një shesh, lokal, shtëpi dhe rreth 3 km është fshati Mbreshtan. Në veri të pronës është truall i lirë dhe kalon rrugë dytësore e fshatit, vazhdojnë shtëpi

dhe rreth 5 km është Ura vajgurore, ndërsa në anën jugore janë shtëpi të fshatit dhe më tej disa fshatra. Zona ku ndodhet prona është kryesisht zonë rurale, të një niveli të ulët ekonomik, me përdorim miks. Akses i pronës është i mirë, direkt nga rruga kryesore e zonës, me rrugën dytësore. Rruga kryesore është me asfalt, kurse rrugët e brendshme të fshatit janë me cakëll.

B-PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Prona, objekt i këtij vlerësimi, është godina e vecantë e postës, vendosur mbi një sipërfaqe trualli 160 m² dhe sipërfaqe ndrtimore 160 m², dhe lartësi 2,6 m, ndërtuar në vitin 1987. Prona është e ndërtuar mbi themele guri dhe ka konstruksion me mure tulle të plotë me trashësi 25 cm, nën një mbulesë me soletë, e cila paraqitet në gjendje normale. Fasada është e suvatuar dhe e lyster. Akses i pronës realizohet direkt nga rruga dytësore, nëpërmjet truallit të saj, në anën veriore. Trualli i lirë shërben si shesh i parrethuar,uar pjesërisht me cakëll.

Prona paraqitet në përgjithësi në gjendje dhe kushte jo të mira mirëmbajtjeje. Përbëhet nga salla e klientëve me banakun, dy ambiente ndihmëse dhe tualeti. Ambientet e brendshme të pronës janë me rifinitura të amortizuara, me dysHEME të shtruara me pllaka gres. Muret dhe tavanet janë të suvatuar dhe të lyster, por të amortizuara. Vetratat e dritareve dhe dyert e brendshme janë duralumin. Dritaret kanë edhe zgara metalike mbrojtëse. Dera kryesore e hyrjes është nga ana perëndimore e godinës. Ajo është duralumin me dy kanata dhe me qepen metalik mbrojtës. Tualeti është me pllaka majolike në muret anësore dhe i kompletuar me paisje të thjeshta porcelani. Furnizimi me energji elektrike dhe ujë realizohet nga rjetet e zonës.

FILIALI KORCE

1. ZYRA POSTARE ERSEKE-QENDER

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona objekt vlerësimi janë zyrat e postës, të cilat ndodhen në qytetin e Ersekës, 211 km në juglindje të Tiranës, rreth 45 km në jug të qytetit të Korçës.

Prona ndodhet buzë rrugës kryesore, në anën perëndimore të saj.

Në perëndim, rreth 150 m, është kopshti fëmijëve, ndërsa në lindje është rruga kryesore dhe më tej, rreth 80 m, është ambulanca dhe spitali i qytetit. Në veri, rreth 60 m, është ndërtesa e AMC-së, ndërsa në jug, rreth 20 m, është stadiumi “Gramozi” i qytetit.

Zona ku ndodhet prona është kryesisht zonë urbane, ekonomikisht e një niveli të mesëm ekonomik, me përdorim miks. Përreth tij ndodhen objekte rezidenciale me pallate banimi, zyra, lokale shërbimi, dyqane dhe ndërtesa institucionale.

Akses i pronës është i mirë, direkt nga rruga kryesore e qytetit.

Infrastruktura dhe rrugët janë në gjendje të mirë, pajisur me ndriçim rrugor, trotuare të shtruara me pllaka betoni.

B-PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Prona, objekt i këtij vlerësimi, është kati përdhe i një ndërtese 1-katshe, e ndërtuar në vitet 80' dhe është rikonstruktuar në vitin 2001, e cila është në vazhdim të një pallati 4-katësh. Ndërtesa ka konstruksion të kombinuar kollona, trare dhe soleta b/arme me mur tulle me trashësi 25 cm dhe 12 cm për muret e jashtme e të brendshme.

Arkitektura e jashtme e ndërtesës është tip e viteve të ndërtimit, në përshtatje me ndërtesat përreth të ndërtuara në vitet 70-80-të. Fasada e ndërtesës është e suvatuar, dhe e lyer. Dyert e jashtme dhe vetratat janë profile duralumini me xham dhe janë të siguruar me qepena metalike. Ndërtesa ka hyrje kryesore në anën lindore të saj, direkt nga rruga kryesore, ku bëhen edhe shërbimet me klientin, si dhe në pjesën mbrapa ndërtesës e cila shërben për personelin. Trotuari para pronës është i shtruar dhe i sistemuar. Aksesit në pronë shumë i mirë, pasi realizohet drejtpërdrejtë nga trotuari i rrugës kryesore. Në pjesën e pasme të pronës, ndodhet hyrja për në ambientet e dhomës së sigurisë, dera e të cilës është e siguruar me zgarë metalike. Hyrja për në këtë ambient, realizohet nëpërmjet katër shkallëve betoni, të cilat aksesojnë sheshin e pallatit. Fasada e kësaj pjese të pronës, është e suvatuar dhe e lyer, por disi e amortizuar.

Aktiviteti i postës kryhet në katin përdhe me sipërfaqe 93.5 m², e cila nga brenda përbëhet nga ambientet e shërbimit të klientit, ambientet e zyrave, korridori. Ambientet janë të rikonstruara dhe paraqiten në kushte e gjendje relativisht të mirë mirëmbajtje, pasi në to vihen re disa dëmtime të shkaktuara nga lagështia. Dyshemeja e të gjitha ambienteve, është e shtruar me pllaka gresi. Muret dhe tavanet janë të suvatuara, patinuara dhe lyera. Dyert e dritaret janë me profile duralumini e xham. Banaku i sportelit është i veshur me pllaka mermeri e me vetratë duralumini në lartësi.

Tualeti është i paisur me vc e lavaman, i shtruar me pllaka gres dhe i veshur pjesërisht me pllaka majolike, por në gjendje jo funksionale. Aktualisht shërben më tepër si vendmagazinimi.

2. ZYRA E ADMINISTRATES SE DEGES ERSEKE

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona objekt vlerësimi janë zyrat e postës, të cilat ndodhen në qytetin e Ersekës, 211 km në juglindje të Tiranës, rreth 45 km në jug të qytetit të Korçës.

Prona ndodhet buzë rrugës kryesore, në anën perëndimore të saj.

Në perëndim, rreth 150 m, është kopshti fëmijëve, ndërsa në lindje është rruga kryesore dhe më tej, rreth 80 m, është ambulanca dhe spitali i qytetit. Në veri, rreth 60 m, është ndërtesa e AMC-së, ndërsa në jug, rreth 20 m, është stadiumi i “Gramozi” qytetit.

Zona ku ndodhet prona është kryesisht zonë urbane, ekonomikisht e një niveli të mesëm ekonomik, me përdorim miks. Përreth tij ndodhen objekte rezidenciale me pallate banimi, zyra, lokale shërbimi, dyqane dhe ndërtesa institucionale. Infrastruktura dhe rrugët janë në gjendje të mirë, pajisur me ndriçim rrugor, trotuare të shtruara me pllaka betoni.

B-PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Prona, objekt i këtij vlerësimi, është kati përdhe i një pallati 4-katsh me bodrum, e ndërtuar në vitet 80’.

Ndërtesa ka konstruksion të kombinuar kollona, trarë dhe soleta b/ar me mur tulle me trashësi 25 cm dhe 12 cm për muret e jashtme e të brendshme.

Arkitektura e jashtme e ndërtesës është tip e viteve të ndërtimit, në përshtatje me ndërtesat përreth të ndërtuara në vitet 70-80-te. Fasada e pallatit është e pa suvatuar dhe e pa lyer. Dyert e jashtme metalike dhe e mbylltur me zgarë hekuri. Ndërtesa ka hyrje kryesore në anën perëndimore të saj dhe hyrja për në pronë realizohet nga shkalla e pallatit. Aktiviteti i postës kryhet në katin përdhe të një pallati 4-katsh me bodrum, me sipërfaqje 38.1 m², e cila nga brenda përbehet nga ambientet e zyrave, depo, tualeti e koridori. Ambientet janë të rikonstruara dhe paraqiten në kushte e gjendje të mirë mirëmbajtje. Dyshemeja e të gjitha ambienteve është e

shtruar me pllaka gresi. Muret dhe tavanet janë suvatuara dhe lyera. Dyert e dritaret janë duralumini e xham. Tualeti është i shtruar në dysHEME me pllaka gresi dhe i veshur në mure me pllaka majolike, por pllakat e mureve në shumë pjesë mungojnë. Suvatimi i mureve të tualetit është i amortizuar nga lagështia. Tualeti është i paisur me v.c. e lavaman, i shtruar me pllaka gres dhe i veshur pjesërisht me pllaka majolike, por në gjendje jo funksionale. Aktualisht shërben më tepër si vendmagazini.

3. ZYRA E ADMINISTRATES KORCE

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona ndodhet në rrugën “Edith Durham” të qytetit të Korcës, në jug të Teatrit “A,Z,Çajupi”.

Në veri prona kufizohet godinën e Teatrit të qytetit dhe në distancë rreth 180 m, kalon rruga “Midhi Konstani”. Më në veri ndodhet një lulishte dhe në distancë rreth 600 m gjendet territori i ish kombinatit Tekstil.

Në jug prona kufizohet me rrugën “Edith Durham” dhe më tej në distancë rreth 200 m, ndodhet Gjimnazi “Themistokli Gërmenji”. Më në jug, në distancë rreth 320 m në vijë ajrore, ndodhet Godina e Bashkisë. Në jug-lindje në distancë rreth 70 m gjenden Hotel “Grandi” dhe “Kocibelli” dhe në distancë rreth 150 m ndodhet Biblioteka “Thimi Mitko”. Në lindje prona kufizohet me Sheshin e Teatrit dhe në distancë rreth 60 m, kalon Bulevardi “Shën Gjergji”.

Në Perëndim prona kufizohet me disa njësi, pjesë të pallatit 5 katësh ku bën pjesë edhe zyra postare dhe më në perëndim, në distancë rreth 150 m në vijë ajrore, kalon rruga “Kico Greco” dhe në distancë rreth 200 m ndodhet territori i Pazarit të Korcës. Zona është e përbërë nga ndërtime 5 katëshe dhe ku ndodhen disa insitucione shtetërore. Infrastruktura është e rehabilituar me rrugë të shtruara dhe e pajisur me trotuare dhe ndricim rrugor.

B-PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Njësia është pjesë e një pallati të ndërtuar rreth viteve 1980 dhe ndodhet në katin përdhe, një pjesë të katit nëntokë dhe një pjesë të katit të parë të saj. Ndërtesa ka konstruksion me themele të vazhduara, me mure perimetral tulle, solete me traveta dhe të hidroizoluar. Fasada e njësisë është e suvatur dhe e veshur me pllaka guri dekorative.

Pjesa e brendshme e godinës është me rifinitura të mira dhe është e gjitha rikonstruktuar me infrastrukturë të brendshme (instalimet elektrike, hidraulike, shtrim dysHEMEJE, vendosje dyer, dritare. etj). Ambjenti i katit përdhe është i përbërë nga 1 ambjent sporteli, 6 zyra dhe një tualet dhe koridor. Ambjenti i katit të parë është i përbërë nga 5 ambjente zyra, koridor dhe 1 tualet.

DysHEMEJA në të gjithë ambjentet është e shtruar me pllaka gres dhe e pajisur me plintues. Muret dhe tavanet janë të suvatur dhe të lyer.

Ambjenti i hollit i ndarë në disa ambjente, ku ambjenti i pritjes së klientëve zë hapësirën më të madhe, kurse dy ambjentet e shërbimit ndodhen një në katin përdhe dhe një në ndërkat. Ambjenti i shërbimit në katin e parë, është i ndarë me banak në formë L-je, kurse ai i ndërkatit me një banak të gjatë të drejtë dhe në hapësirën e lartësisë mbi ½ të tyre, vendosur xhama në profile duralumini, kurse në pjesën e sipërme ka tavan të varur me ndriçim. Shkallët e brendshme të pronës, ato të hollit, ndërkatit, katit të parë dhe ato zbritëse për katin nëntokë, me bazamakë mermeri, shkallët zbritëse të katit nëntokë, të siguruara me parrmak hekuri të thjeshtë nga një krah.

Vetratat e dritareve, përjashtuar ato të fasadës e cila është me vetratë xhami të fiksuar në konstruksion me profile duralumini, janë me profile duralumini dhe pjesërisht të mbrojtura me zgara hekuri. Nga pjesa e brendshme e dritareve, vendosur grila të varura me material metal-plastikë. Dyert e brendshme janë pjesërisht druri tamburato dhe pjesa tjetër janë me profile duralumini me xham. Tualetet janë të shtruara me pllaka gres dhe muret të veshura me pllaka majolike. Tualetet janë të pajisura me vc e lavaman. Instalimet elektrike janë brenda murit me celësa e priza.

4. ZYRA POSTARE KORCA NR.1

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona ndodhet në qytetin e Korçës, në anën veriore të rrugës “Jani Dudo”.

Prona ndodhet në veri-lindje të qendrës së Korçës në distancë rreth 600 në vijë ajrore.

Në dy drejtimet veriore e lindore prona kufizohet me ndërtesa karakteristike korcare 1-2-katëshe dhe me rrugë me kalldrëm nga ana jugore, ndërsa nga ana perëndimore me rrugën “Kongresi Përmetit”, të shtruar me asfalt.

Në distancë rreth 700 m në vijë ajrore në anën veriore gjendet Parku “Rinia”.

Në jug- perëndim në distancë rreth 350 m në vijë ajrore ndodhet Godina e Prefekturës.

Infrastruktura është në gjendje të mirë me rrugë të rikonstruktuar me natyrë me kalldrëm. Rruga është me trotuarë dhe e pajisur me ndriçim rrugor.

B-PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Zyra postare është pjesë përbërëse e një godine 2 katëshe. Konstruksioni është me themele beton/arme, me cati të mbuluar me tjegulla, me mure tulle perimetralë. Fasada e pallatit nuk është e suvatur, vetëm sipërfaqet e zyrave postare janë pjesërisht të suvatuara, e pjesërisht të veshura me pllaka guri. Ndërtesa është e ndërtuar rreth viteve 1960, por është rikonstruktuar vitet e fundit.

Prona është rikonstruktuar dhe paraqitet në përgjithësi në gjendje dhe kushte të mira mirëmbajtjeje. Zyra postare është e përbërë nga një ambjent me sportel një zyrë dhe një tualet. Niveli i rifiniturave të ndërtesës është i mirë. Muret dhe tavanet janë të suvatur dhe të bojatisur. Dyshemeja është e shtruar me pllaka gresi dhe me plintusa përreth. Dyert e brendëshme, vetratat dhe dritaret janë me profile duralumini. Dera hyrëse dhe dritaret të mbrojtura të mbrojtura me qepena metalike. Tualeti është i shtruar me pllaka gres dhe mure të veshura me pllaka majolike. Tualeti është i pajisur me lavaman dhe ëc. Instalimet elektrike janë brenda murit për celësa e priza.

5. ZYRA POSTARE DEVOLL

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona ndodhet në qytetin e Bilishtit, i cili ndodhet rreth 20 km në lindje të qytetit të Korçës. Prona ndodhet në anën veri-lindore të qendrës së qyteti Bilishtit, në distancë rreth 280 m në vijë ajrore.

Në veri dhe në lindje prona kufizohet me rrugën Korçë - Nevecisht dhe me në veri gjenden toka të lira të sistemuara dhe të mbjella.

Në perëndim prona kufizohet me një shesh dhe në distancë rreth 120 m, ndodhet godina e Gjimnazit të qyteti Bilisht.

Në jug prona kufizohet me një nga rrugët kryesore të qytetit e më tej, gjenden ndërtesa 4-5 katëshe banimi .

Rruga kryesore është e shtruar me asfalt, ndërsa rrugët e brendshme pjesërisht me asfalt e pjesërisht janë të shtruara me kalldrëm .

B-PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Zyra postare është pjesë e një ndërtese 5 katëshe të ndërtuar me tulla, me solete beton arme, në pjesën e jashtme është e suvatuar dhe e lyer. Ndërtesa është e vitit 1987, por prona i është nënshtruar rikonstruksionit 10-12 vitet e fundit. Ambjenti është i përshtatur në një ambjent pritës, 3 zyra, një korridor dhe një tualet. Muret e jashtëm janë të suvatuar dhe të lyer. Aksesipër në pronë shumë i mirë, pasi realizohet drejtpërdrejt me rrugën kryesore të qytetit. Pjesa e brendshme e godinës është me rifinitura të mira dhe është e gjitha e rikonstruktuar. Dyshemeja është e shtruar me pllaka gres dhe e pajisur me plintues. Muret dhe tavanet janë suvatuar dhe të lyer. Dera hyrëse dhe dritaret janë me profile duralumini, të pajisura me kangjella metalike, dyert e brendshme dhe dera e tualetit, janë me profile duralumini. Ambjenti i shërbimit i ndarë me një banak druri, në lartësi të cilin janë vendosur vetrata duralumin me xham. Tualeti është i shtruar me pllaka dhe muret janë të veshura me pllaka majolike.

Instalimet elektrike dhe hidraulike janë realizuar të brendshme dhe janë të lidhura me rrjetet kryesore inxhinierike të zonës.

FILIALI GJIROKASTER

1. ZYRA POSTARE BALLABAN

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona objekt i vlerësimit tonë është zyra postare e ndodhur në fshatin Ballaban të rrethit të Përmetit me sip. trualli 51.1 m² i zënë me ndërtim 30.6 m², me nr.ip.85 pasurie. Prona ndodhet në fshatin Ballaban të Njësisë Administrative Ballaban, rreth 15 km në veri të Këlcyrës dhe 32 km në veri të Përmetit; Kufizimet e pronës janë; Në Veri. Territor i lire; Në Lindje. Rruge; Në Jug. Territor i Lire & Në Perëndim, territor i lirë. E parë nga lart zona ka një ndërthurje, shtëpish banimi të fshatit e toka bujqësore. Zona është kryesisht zonë rurale fshati. Infrastruktura e saj është normale. Objekt vlerësimi është edhe motomjeti me targë AL 806, pjesë e inventarit të Zyrës Postare Ballaban.

B-PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Godina në të cilën ndodhet prona është një ndërtesë një katëshe , me konstruksion beton arme, mure tulle, mbuluar me solete monolite beton arme. Ndërtesa nga jashtë pjesërisht është e rikonstruktuar në gjëndje të mirë, e suvatuar dhe e lyer dhe pjesërisht është tej mase e amortizuar, e pasuvatuar dhe e palyer. Godina është ndërtuar rreth vitit 1989 dhe sipërfaqia prej 30.6 m² është rikonstruktuar 7-8 vitet e fundit. Pjesa e pronës e cila është e rikonstruktuar dhe që shërben si zyrë, paraqitet në përgjithësi në gjëndje dhe kushte të mira mirëmbajtjeje. Prona është e përbërë nga ambienti i sportelit të shërbimit dhe ambienti i zyrës. Prona ka një sipërfaqe ndërtimore prej 30.6 m² dhe trualli 51.1 m². Lartësia e katit është 3.0 m. Ambientet e brendshme të pronës janë me rifinitura normale të rikonstruktuar, me dysheme të shtruara me pllaka gresi dhe të pajisur me plintues anësor përgjatë mureve. Muret dhe tavanet janë të suvatuar dhe të lyer. Vetratat e dritareve dhe dyerve janë me profile duralumini me xham. Vetratat e dritareve dhe dyerve janë me profile duralumini me xham. Ato janë të mbrojtura me

zgara metalike. Dera e hyrjes në pronë, me profil duralumini me xham e mbrojtur me qepen metalik.

Instalimet elektrike dhe hidrosanitare janë të thjeshta në gjendje normale.

Pjesa e pronës e cila është e parikonstruktuar dhe që aktualisht nuk është në përdorim, por që më parë ka qënë zyrë bankare, paraqitet në përgjithësi në gjendje dhe kushte tej mase të amortizuara. Prona ka një sipërfaqe ndërtimore prej 66.5 m² dhe trualli 96.2 m². Lartësia e katit është 3.0 m. Ambientet e brendshme të pronës janë me rifinitura të amortizuara tej mase. Në mure e tavane ka lagështirë, mungojnë dyert dhe dritaret, ka të vendosura zgara metalike në dritare e dyrer, shtresa e pllakave është tej mase e amortizuar. Mungon rrjeti elektrik dhe hidrosanitar.

Prona përbën një njësi e cila paraqitet në gjendje të amortizuar. Lartësia e katit është 3.0 m. Hyrja në të realizohet nga ana perëndimore e ndërtesës nëpërmjet një dere në trajtën e një zgare metalike. Ka nevojë për rinovime capitale: suvatime te jashte dhe te brendshme, riparime të soletës, dyer, dritare, shtresa e dyshemese, instalimeve elektrike.

2. ZYRA POSTARE QESARAT

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona objekt vlerësimi ndodhet në fshatin Qesarat, rreth 11.5 km në veri-perëndim të qytetit Memaliaj, rreth 19 km në veri-perëndim të qytetit të Tepelenës dhe 55 km në jug-perëndim të Levanit të Fierit.

Prona ndodhet në anën veri-lindore të rrugës nacionale që lidh qytetin e Memaliaj me Levanin e Fierit, buzë kësaj rruge nacionale.

Në veri prona kufizohet me godina banimi të fshatit dhe më tej me toka të lira.

Në jug të pronës kalon rruga Levan – Tepelenë dhe më tej toka të lira.

Në lindje të pronës objekt vlerësimi ndodhet qendra e fshatit dhe më tej edhe shkolla, dhe kodrinat e zonave të banuara, ndërsa në perëndim kalon rruga Levan – Tepelenë.

Zona ku ndodhet prona është zonë rurale me nivel ekonomik të ulët, me shtëpi banimi 1-2 katëshe e dyqane të vogla, kryesisht buzë rrugës. Akses i pronës është i mirë nga rruga kryesore e fshatit e cila lidh Levanin e Fierit me qytetin e Tepelenës. Infrastruktura e rrugës kryesore është në gjendje normale mirëmbajtje.

B-PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Prona është një njësi e cila ndodhet në qendër të fshatit Qesarat, buzë rrugës që lidh qytetin e Tepelenës me Levanin e Fierit dhe më tej me qytetet e Fierit dhe Vlorës. Prona ndodhet në katin përdhe të një godine dy katëshe, ku ndodhen edhe ambientet e zyrave të Njësisë Administrative Qesarat. Godina dy katëshe ku ndodhet prona, është ndërtuar rreth viteve 80', me konstruksion themele guri e mure tulle të plotë të kombinuar me breza betoni, e mbuluar me cati me tjegulla. Fasada e pronës është e suvatur dhe e lyer.

Hyrja për në pronë realizohet nga ana perëndimore e ndërtesës, nëpërmjet disa këmbë shkallë betoni. Prona është një shtëpi postare me sipërfaqe 45 m², aktualisht zyre postare e fshatit Qesarat, të komunës Qesarat. Ajo përbehet nga një ambient për shërbimin për klientin, një ambient ndihmës zyre për personelin dhe një tualet. Rifiniturat e saj janë të thjeshta, dyshemeja është shtruar me pllaka gresi, muret dhe tavanet janë të suvatur dhe të lyer. Porta e hyrjes në pronë dhe dritaret janë me profile duralumini me xham. Ato janë të mbrojtur me qepen metalik si në dyer, ashtu edhe në dritare.

Tualeti është i shtruar me pllaka gresi dhe i veshur në mure deri në lartësinë rreth 2 m me pllaka

majolike. Ai është i pajisur me paisje hidrosanitare porcelani të thjeshta si vc dhe lavaman

3. ZYRA POSTARE ERIND

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Zona ku ndodhet prona është zonë rurale me nivel ekonomik të ulët, me shtëpi banimi 1-2 katëshe e dyqane të vogla, kryesisht buzë rrugës. Akses i pronës është i mirë nga rruga kryesore e fshatit e cila lidh Levanin e Fierit me qytetin e Tepelenës. Infrastruktura e rrugës kryesore është në gjendje normale mirëmbajtje. Prona ndodhet në fshatin Erind, në anën veriore të qytetit të Gjirokastrës, rreth 8 km larg tijë në vijë ajrore. Prona është e vendosur në anën perendimore të rrugës kryesore të fshatit, rrugë që lidh pronën me qendrën e fshatit si dhe me drejtimet e tjera të zonës.

Kufizimet e pasurise janë, Në Veri. Pas. 69/68; Në Lindje .Pas. 169/69; Në Jugu pas. 169/63 ; Në Perëndim pas. 169/68.

E parë nga lart zona ka një ndërthurje shtëpish banimi e toka bujqësore. Zona është kryesisht zonë banimi, industriale dhe tregëtare. Infrastruktura e saj është normale.

B-PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Godina në të cilën ndodhet prona është një ndërtesë një katëshe , me konstruksion beton arme, mure tulle, mbuluar me solete monolite beton arme. Ndertesa nga jashte është e suvatuuar dhe e lyster. Godina është ndërtuar rreth vitit 1987 dhe eshte e rikonstruktuar vitet e fundit.

Prona është e rikonstruktuar vitet e fundit dhe paraqitet në përgjithësi në gjendje dhe kushte të mira mirëmbajtjeje. Prona është e përbërë nga ambienti i sportelit të shërbimit dhe ambientet e zyrave dhe ambiente ndihmëse. Prona ka një sipërfaqe prej 98.5 m2 . Ambientet e brendshme të pronës janë me rifinitura normale te rikonstruktua, me dysHEME të shtruara me pllaka gresi dhe të pajisur me plintuesa anësor përgjatë mureve. Muret dhe tavanet janë të suvatuara dhe të lyster por aktualisht kanë lagështirë për shkak se pikon taraca e mbulesës. Vettratat e dritareve dhe dyerve janë me profile duralumini me xham. Ato janë të mbrojtura me qepena

Zyra Postare nga brenda është totalisht amortizuar.Brenda të gjithë suvatimet,dyert,dritaret dhe rrjeti elektrik është totalisht i amortizuar dhe i vjetër kjo si rjedhojë e mos investimit shumë vjeçar.Ndëçimi i dobët dhe i dëmtuar,tavanet e varura të dëmtuara rëndë.Shtresat e pllakave janë të dëmtuara dhe të dala boje.Tualetët janë në një gjendje të rënduar pasi pajisjet dhe instalimet hidraulike janë tejet të amortizuara.Banakët e shërbimit,tavolinat dhe karriget e punjonjësve janë krejtësisht të amortizuara dhe të dala boje.Të gjithë dritaret dhe dyert janë të amortizuara.Ka probleme të theksuara lagështie nga tarrace e amortizuar.

4. ZYRA POSTARE SOFRATIKË

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona ndodhet në fshatin Sofratikë, në anën jugore të qytetit të Gjirokastrës rreth 11 km larg në vijë ajrore dhe në anën perëndimore të autostradës Gjirokastër-Kakavijë, rreth 110 m larg në vijë ajrore.

Prona pozicionohet ne anen perendimore të rrugës së asfaltuar të fshatit, në akses të drejtpërdrejtë në të. Me anë të kesaj rrugë, realizohet lidhja e pronës me autostradën Gjirokastër-Kakavije dhe me drejtimet e tjera të zonës. Ajo ndodhet në anën veri-lindore te qendrës së fshatit

rreth 300 m larg në vijë ajrore.

Kufizimet e pasurisë janë; Veri. Pas. 212/24; Lindje .Pas. 212/22; Jugu .pas. 212/22; Perëndim pas. 212/22.

E parë nga lart zona ka një ndërthurje magazinash, shtëpish banimi e toka bujqësore , si dhe në të kalojnë e kryqëzohen rrugë të rëndësishme automobilistike. Zona është kryesisht zonë banimi, industriale dhe tregëtare. Infrastruktura e saj është normale.

B-PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Godina në të cilën ndodhet prona është një ndërtesë një katëshe , me konstruksion beton arme, mure tulle, mbuluar me solete monolite beton arme. Ndërtesa nga jashtë është e suvatuar dhe e lyer. Godina është ndërtuar rreth vitit 1986 dhe është e rikonstruktuar vitet e fundit.

Prona është e rikonstruktuar vitet e fundit dhe paraqitet në përgjithësi në gjendje dhe kushte të mira mirëmbajtjeje. Prona është e përbërë nga ambienti i sportelit të shërbimit me ambiente ndihmëse. Prona ka një sipërfaqe prej 61.0 m2. Ambientet e brendshme të pronës janë me rifinitura normale te rikonstruktura, me dysheme të shtruara me pllaka gresi dhe të pajisur me plintuesa anësor përgjatë mureve. Muret dhe tavanet janë të suvatuara dhe të lyer. Vetratat e dritareve dhe dyerve janë me profile duralumini me xham. Ato janë të mbrojtura me qepena metalik.

5. ZYRA POSTARE KARDHIQ

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona ndodhet në fshatin Çepunë, në anën veri-perendimore të qytetit të Gjirokastrës, rreth 9 km larg tijë në vijë ajrore. Prona ndodhet në anën perëndimore të autostrades Tepelene-Gjirokaster rreth 150 m larg ne vije ajrore. Kufizimet e pasurise janë; Në Veri. Pas. 52/1; Në Lindje .Pas. 52/1; Në Jugu pas. 52/32 ; Në Perëndim pas. 52/1.

E parë nga lart zona ka një ndërthurje magazinash, shtëpish banimi e toka bujqësore , si dhe në të kalojnë rrugë të rëndësishme automobilistike. Zona është kryesisht zonë banimi, industriale dhe tregëtare. Infrastruktura e saj është normale.

B-PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Godina në të cilën ndodhet prona është një ndërtesë një katëshe , me konstruksion beton arme, mure tulle, mbuluar me solete monolite beton arme. Ndertesa nga jashte është e suvatuar dhe e lyer. Godina është ndërtuar rreth vitit 1987 dhe eshte e rikonstruktuar vitet e fundit.

Prona është e rikonstruktuar vitet e fundit dhe paraqitet në përgjithësi në gjendje dhe kushte të mira mirëmbajtjeje. Prona është e përbërë nga ambienti i sportelit të shërbimit dhe ambientet e zyrave dhe ambiente ndihmëse. Prona ka një sipërfaqe prej 100.7 m2 . Ambientet e brendshme të pronës janë me rifinitura normale te rikonstruktura, me dysheme të shtruara me pllaka gresi dhe të pajisur me plintuesa anësor përgjatë mureve. Muret dhe tavanet janë të suvatuara dhe të lyer. Vetratat e dritareve dhe dyerve janë me profile duralumini me xham. Ato janë të mbrojtura me qepena metalik.

FILIALI MAT

1. ZYRA POSTARE BAZ

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona zyra e postës ndodhen në fshatin Baz, 78 km në verilindje të Tiranës, rreth 8 km në vijë ajrore në perëndim të qytetit të Burrelit. Prona ndodhet në qendër të fshatit Baz, në anën veriore të godinës së Komunës, në jug të rrugës automobilistike Tiranë-Burrel. Në jug të pronës, rreth 100 m, është shkolla e mesme “Gjergj Kastrioti” dhe përreth janë shtëpi e toka të fshatit Baz. Zyra postare ndodhet në kati përdhe të një ndërtese 2-katshe, e ndërtuar në vitin 1988. Prona është në një ndërtesë me zyrat e komunës në anën veriore të saj.

Ndërtesa ka konstruksion me themele butobeton, mure perimetralë e ndarës tulle, soletë ndërkati dhe e mbuluar me soletë monolite të hidroizoluar.

Zyrat e postës janë në anën verilindore të sipërfaqes së katit përdhe të godinës dy katëshe dhe zënë një sipërfaqe 68 m². Ajo përbëhet nga ambienti i shërbimit të klientit, zyra, koridori dhe tualeti.

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Zyra Postare nga brenda është totalishtë amortizuar. Brenda të gjithë suvatimet, dyert, dritaret dhe rrjeti elektrik është totalisht i amortizuar dhe i vjetër kjo si rjedhojë e mos investimit shumë vjeçar. Ndiçimi i dobët dhe i dëmtuar, tavanet e varura të dëmtuara rëndë. Shtresat e pllakave janë të dëmtuara dhe të dala boje. Tualetët janë në një gjendje të rënduar pasi pajisjet dhe instalimet hidraulike janë tejet të amortizuara. Banakët e shërbimit, tavolinat dhe karriget e punjonjësve janë krejtësisht të amortizuara dhe të dala boje. Të gjithë dritaret dhe dyert janë të amortizuara. Ka probleme të theksuara lagështie nga tarrace e amortizuar.

2. ZYRA POSTARE GJORICE

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Zyra e postës ndodhet në fshatin Gjoricë e Eper të Bulqizës në anën lindore të fshatit , 149 km në verilindje të Tiranës, dhe rreth 22 km në verilindje të Bulqizës. Zyra ndodhet në të njëjtën godinë me zyrat e Komunës dhe Ambulancën. Në veri, rreth 80 m, është rruga automobilistike, ndërsa në jug është truall i lirë. Në lindje, rreth 70 m, është rruga automobilistike, ndërsa në perëndim është ndërtesë banimi 1-2 katshe dhe truall i lirë. Zyra postare ndodhet në katin përdhe të një ndërtese 1-katshe, e ndërtuar në vitet 80’ dhe është në të njëjtën godinë me zyrat e Komunës dhe Ambulancën. Aktiviteti i postës kryhet në katin përdhe të një ndërtese 1-katëshe, në një ambjent me sipërfaqje 15 m², e cila përbehet nga salla e shërbimit të klientëve dhe koridori.

Ndërtesa ka konstruksion me mur tulle (prodhuar në mënyrë artizanale-qerpiç) me trashësi 25 cm dhe 12 cm per muret e jashtme e te brendshme dhe e mbuluar me çati me tjegulla.

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Zyra Postare nga brenda është totalishtë amortizuar. Në fasadën e ndërtesës vërehen dëmtime të rënda të suvasë si dhe krisje pjesore e murit. Dera e jashtme dhe dritaret janë profile duralumini me xham dhe janë të siguruara me qepena e zgara metalike. Brenda të gjithë suvatimet, dyert, dritaret dhe rrjeti elektrik është totalisht i amortizuar dhe i vjetër kjo si rjedhojë e mos investimit shumë vjeçar. Ndiçimi i dobët dhe i dëmtuar, tavanet e varura të dëmtuara rëndë. Shtresat e pllakave janë të dëmtuara dhe të dala boje. Nuk ka tualet për staffin dhe klientët. Banakët e shërbimit, tavolinat dhe karriget e punjonjësve janë krejtësisht të amortizuara dhe të dala boje. Të gjithë dritaret dhe dyert janë të amortizuara. Ka probleme të theksuara

lagështie nga tarrace e amortizuar.

3. ZYRA POSTARE BULQIZE LAGJA E RE

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Zyra postare ndodhet, në Lagjen e Re - Bulqizë, 127 km në verilindje të Tiranës. Prona ndodhet në Lagjen e Re, anën perëndimore të saj. Në veri të pronës, rreth 20 m, është rruga automobilistike, e më tej janë pallate banimi, ndërsa në jug rreth 40 m është rrugë e brendshme e më tej janë ndërtesa banimi 2-3-katshe. Në lindje, kufizohet me pallate 3-4 katshe, ndërsa në perëndim është sheshi i brendshëm i pallatit dhe më tej rruga automobilistike. Aktiviteti i postës kryhet në katin përdhe të një pallati 5-katsh ndërtuar në vitin 1983, me sipërfaqje 36 m², e cila përbëhet nga sallat e shërbimit të klientëve, koridori dhe tualeti. Pallati ka konstruksion të kombinuar kollona, trare dhe soleta b/arme me mur tulle me trashësi 25 cm dhe 12 cm për muret e jashtme e të brendshme. Arkitektura e jashtme e ndërtesës është tip e viteve të ndërtimit, në përshatje me ndërtesat përreth të ndërtuara në vitet 70-80-te.

Ndërtesa ka hyrje kryesore në anën perëndimore të saj, direkt nga sheshi i brendshëm i pallatit..

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Zyra Postare nga brenda është totalisht amortizuar. Brenda të gjithë suvatimet, dyert, dritaret dhe rrjeti elektrik është totalisht i amortizuar dhe i vjetër kjo si rrjedhojë e mos investimit shumë vjeçar. Ndiçimi i dobët dhe i dëmtuar, tavanet e dëmtuara. Shtresat e pllakave janë të dëmtuara dhe të dala boje. Tualetët janë në një gjendje të rënduar pasi pajisjet dhe instalimet hidraulike janë tejet të amortizuara. Banakët e shërbimit, tavolinat dhe karriget e punjonjësve janë krejtësisht të amortizuara dhe të dala boje. Të gjithë dritaret dhe dyert janë të amortizuara. Ka probleme të theksuara lagështie nga tarrace e amortizuar.

4. ZYRA POSTARE PESHKOPI(DOBROVE)

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Zyra postare ndodhet, në Dobrovë të Peshkopisë, 185 km në verilindje të Tiranës dhe rreth 1 km në lindje të qendrës së qytetit të Peshkopisë. Prona ndodhet buzë rrugës kryesore “Vehbi Dibra”, në anën perëndimore të saj.

Në perëndim, janë ndërtesa banimi 1-4 katshe, ndërsa në lindje rreth 30 m, është rruga “Vehbi Dibra”.

Në veri, është shkolla “ Irfan Hajrullai”, ndërsa në jug janë ndërtesa banimi 1-4 katshe.

Aksesi pronës është i mirë, pasi realizohet nëpërmjet rrugës kryesore “Vehbi Dibra

Prona është e përbërë nga ambientet e sporteve të shërbimit (në anën perëndimore të godinës) dhe ambientet e zyrave të administratës dhe ambiente ndihmëse (në anën lindore të godinës).

Zyra postare nga brenda përbëhet nga holli në hyrje ku është vendosur dhe ambienti i shërbimit të klientit si dhe ambientet e brendshme të dhomave të shërbimit dhe ambienteve ndihmëse. Ambienti i zyrave të administratës, nga brenda përbëhet nga ambiente zyrash dhe tualetet. Dyshemeja në të gjitha ambientet është e shtruar me pllaka gresi dhe janë vendosur plitues anësor përgjatë mureve.

Ambientet e përbashkta janë ambiente holli dhe shkallësh të cilat janë në bashkëpronësi me Albtelekomin.

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Zyra Postare nga brenda është totalisht e amortizuar. Brenda të gjithë suvatimet, dyert, dritaret dhe rrjeti elektrik është totalisht i amortizuar dhe i vjetër kjo si rjedhë e mos investimit shumë vjeçar. Ndiçimi i dobët dhe i dëmtuar tavane të dëmtuara rëndë. Shtresat e pllakave janë të dëmtuara dhe të dala boje. Tuelalet janë në një gjendje të rënduar pasi pajisjet dhe instalimet hidraulike janë tejet të amortizuara. Banakët e shërbimit, tavolinat dhe karriget e punjonjësve janë krejtësisht të amortizuara dhe të dala boje. Të gjithë dritaret dhe dyert janë të amortizuara. Ka probleme të theksuara lagështie.

5. ZYRA POSTARE QENDËR-HAS

A-PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA E OBJEKTIT

Zyra Postare ndodhet, në qytetin e Krumës, 170km në verilindje të Tiranës, rreth 250 m në veri të qendrës së qytetit. Në anën veriore të pronës, ndodhen disa godina ekzistuese 4-6 kateshe dhe pjesërisht godina individuale 1-2 kateshe, ndërsa në verilindje, rreth 80 m është xhamia dhe shkolla “Skëndërbeu”. Në anën jugore të pronës, kalon rruga “Demokracia” në afërsi të saj ndodhen disa godina ekzistuese 4-6 kateshe në distance rreth 90 m ndodhen disa lulishte, në distance rreth 290 m kalon rruga “28 Nentori”. Në anën lindore të pronës, në distance rreth 50 m kalon rruga kryesore në afërsi të saj ndodhen disa godina individuale 1-2 kateshe.

Zyra postare ndodhet, është e vendosur në katin përdhe të një pallati 5-katsh banimi me sipërfaqe 118.5 m², e ndërtuar në vitin 1984. Ndërtesa ka konstruktion të kombinuar kollona, trare dhe soleta b/arme me mur tulle me trashësi 25 cm dhe 12 cm për muret e jashtme e të brendshme. Ndërtesa është e ndërtuar mbi një pllakë betonarme me një nivel të ngritur rreth 1 m nga toke, ka konstruktion të kombinuar mur tulle e kollona betonarme.

Hyrja e këtij kati realizohet nepermjet dy dyerve me profile duralumini të pajisura me xham të cilat janë të pajisura me qepena metalike, njëra në anën perëndimore dhe tjetra në anën veriore të pallatit. Për tu ngjitur për në kete kat realizimi behet nepermjet disa kembeve shkalle të veshura me pllakë mermeri. Aktiviteti kryhet në katin përdhe të një pallati 5-katsh, me sipërfaqje 118.5 m², e cila nga brenda përbehet nga ambientet e shërbimit të klientit, ambientet e zyrave, tualetit dhe koridore.

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Zyra Postare nga brenda është totalisht e amortizuar. Brenda të gjithë suvatimet, dyert, dritaret dhe rrjeti elektrik është totalisht i amortizuar dhe i vjetër kjo si rjedhë e mos investimit shumë vjeçar. Ndiçimi i dobët dhe i dëmtuar, tavanet të dëmtuara rëndë. Shtresat e pllakave janë të dëmtuara dhe të dala boje. Tuelalet janë në një gjendje të rënduar pasi pajisjet dhe instalimet hidraulike janë tejet të amortizuara. Banakët e shërbimit, tavolinat dhe karriget e punjonjësve janë krejtësisht të amortizuara. Të gjithë dritaret dhe dyert janë të amortizuara. Ka probleme të theksuara lagështie nga tarrace e amortizuar.

KËRKESAT E RIKONSTRUKSIONIT

- **PRISHJET:** Të parashikohet mundësia e prishjes së të gjitha suvave ekzistuese për të dalë në tullë.
- **MURRET:** Të parashikohet suvatimi në ambientet ndihmëse dhe patinim në sallën e shërbimit. Në muret që ka lagështirë të theksuar duhet parë mundësia dhe e veshjes së murit me

veshje gipsi.

- **LYERJE:** Të parashikohet lyerja e të gjithë ambienteve të brendshme dhe të jashtme të Zyrës Postare.
- **RIRGANIZIM I HAPESIRAVE:** Të parashikohet mundësia e prishjeve të mureve ekzistuese pa prekur kolonat e objektit/muret mbajtëse, për të krijuar një organizim më të mirë të sallës dhe të ambienteve ndihmëse.
- **SHTRIMI ME PLLAKA:** Të parashikohet shtrimi me pllaka në të gjithë Zyrën Postare. Standarti i pllakës duhet të jetë 60x60. *(Ngjyrat e pllakave vendosen nga autoriteti kontraktor gjatë zbatim të punimeve)*
- **MOBILIMI:** Të parashikohet banak druri me ndarje xhami mbi sportel. Banaku duhet të jetë i paisur me komodina ndihmëse për secilin punonjës. Xhami mbi sportel duhet të jetë 50 cm i lartë dhe me 10 cm hapësirë boshe për të shkëmbyer materialet punonjësit me klientët.
- **TUALETET:** Të parashikohet tualete me të gjitha pajisjet e reja dhe aty ku nuk ka të parashikohet tualet i ri me të gjitha pajisjet. Të shikohet problematika e lagësirës në qoftëse ka dhe të bëhet hidroizolimi. Dyshemeja e tualetit të shtrohet me pllaka gres/porcelanat dhe veshja e mureve të tualetit të jetë me pllaka majolike. Tualeti duhet të pajiset me hidrosanitare të reja.
- **DYERT:** Të parashikohet që dyert të ndërrohen. Dyert e brendshme të Zyrës Postare duhet të jenë të gjitha prej druri ndërsa dera e tualetit të jetë material alumini. Dera e jashtme e Zyrës Postare, pra fasada duhet të jetë xham triplex me korniz alumini rezistente kundër thyerjeve. Fasada e xhamit duhet të jetë e veshur me adeziv ngjyrë akulli në lartësinë 110cm dhe në mes të saj të jetë e vendosur logo zyrtare e Postës Shqiptare. *(Ngjyrat e dyerve vendosen nga autoriteti kontraktor gjatë zbatim të punimeve)*
- **DRITARET:** Të parashikohet që dritaret të ndërrohen dhe të vendosen të reja. Dritaret ekzistuese duhet të zëvendësohen me dritare alumini dopjo xham ose me vetrata xhami triplex me korniz alumini rezistente kundër thyerjeve për zyrat qendër filiale. *(Ngjyrat e dritareve vendosen nga autoriteti kontraktor gjatë zbatim të punimeve)*
- **NDRICIMI:** Të parashikohet që ndriçimi të jetë LED me përmasa 60X60 për sallën ku të jenë të vendosura në tavan gipsi me fibra 60X60 ndërsa për amjentet ndihmëse duhet të përdoret ndricues LED tavanor.
- **HIROIZOLIMI:** Të parashikohet hidrizolimi taracave të objekteve që janë me solet.
- **TAVANI:** Të parashikohet në sallën e shërbimit tavan gipsi me përmasa 60X60 me fibra dhe kornizim gipsi.
- **RRJETI ELEKTRIK:** Të parashikohet të bëhen të gjitha instalimet elektrike të reja, nga kuadri elektrik deri tek prizat. Për çdo post pune duhet të ketë 2 priza shuko dhe 2 bivalente të vendosura poshtë banakut. Në sallë dhe në ambientet ndihmëse duhen vendosur priza të reja.
- **RRJETI I INTERNETIT:** Të parashikohet që të vendosen 2 priza rrjeti interneti për secilin post pune, si dhe në ambientet ndihmëse.
- **KONDITIONIMI:** Impiantet mekanike në godinë duhet të përzgjidhen në bazë të kërkesave më të larta të kursimit të energjisë, duke përdorur tipologji të përshtatshme për ambientet dhe destinacionin e tyre për realizimin e ngrohje ftohjes kondicionimin dhe furnizimin me ajër të freskët. Të parashikohet vendosja e kondisionerit mural 24BTU Inverter në pjesën e sallës së shërbimit.
- **FASADA:** Të parashikohet pastrimi i të gjithë fasadës së jashtme të objektit, suvatim dhe grafiato. *(Ngjyrat e fasadës vendosen nga autoriteti kontraktor në zbatim të punimeve)*

- **TABELA:** Të parashikohet vendosja e një tabele treguese të re të Zyrës Postare në hyrjen kryesore me material etalbond me çarje me ndriçim led dhe me sensor të erësirës ku të jetë e shënuar “Posta Shqiptare” dhe kodi postar.
- **TABELA EMERGJENCE:** Të parashikohet vendosja e tabelave sinjalizuese në rast emergjence.

DORËZIMET E PROJEKTIT

Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Projekti për rikonstruksimin e Zyrave Postare do të hartohet në përputhje me kërkesat e detyrës së projektimit dhe kushteve teknike të projektit të zbatimit.

Projekti përfundimtar do të përfshijë vizatimet për të gjitha punimet që do kryhen, specifikimet teknike për të gjitha punimet e parashikuara, relacionin teknik përshkrues të punës për secilin prej punimeve, preventivin e punimeve të parashikuara dhe grafikun e punimeve për secilin Filial më vete.

Konsulenti, në përputhje dhe në varësi të projektit të paraqitur duhet të paraqesë edhe preventivin përfundimtar përkatës.

Konsulenti duhet të paraqesë detyrimsht preventivin përfundimtar të punimeve. Çdo zë i këtij preventivi duhet të mbështetet në Klasifikimet Ligjore të Kostove dhe Analizat Teknike të Çmimeve nga Manualet Teknike përkatëse, në përputhje me VKM në fuqi.

Për zërat që nuk përfshihen në këto Manuale të bëhet analiza e çmimit bazuar në testimin e tregut duke marrë tre oferta nga operatorë ekonomike, që operojnë në vendin tonë (oferta që do të bëhen pjesë e dokumentit të dorëzuar) ose analiza të reja teknike.

Çmimet për projektim do të jetë sipas standarteve të shtetit Shqiptar.

Projekti Arkitektonik

Planvendosja e objektit	Shk. 1:500
Planimetritë e gjendjes ekzistuese	
Planimetritë e ndërhyrjeve	Shk. 1:100
Planimetritë e propozuara teknike	Shk. 1:100
Prerje gjatësore dhe tërthore	Shk. 1:100
Detaje të ndryshme arkitektonike	Shk. 1:25/ 1:20/ 1:10

Projekti Hidraulik

Planimetritë e furnizimit me ujë	Shk. 1:100 / 1:50
Planimetritë e shkarkimit të ujrave të zeza	Shk. 1:100 / 1:50
Detaje të ndryshme hidraulike	Shk. 1:25/ 1:20/ 1:10

Projekti Mekanik (Ngrohje Ftohje)

Planimetritë e vendosjes së pajisjeve ng-ft	Shk. 1:100
Planimetritë e shtrirjes së instalimeve të kondicionimit	Shk. 1:100

Detaje të ndryshme Shk. 1:25/ 1:20/
1:10

Projekti Elektrik

Planimetritë e ndriçimit Shk. 1:100

Planimetritë e prizave Shk. 1:100

Planimetritë e rrjetit LAN, telefoni Shk. 1:100

Planimetritë e ndriçimit të Shk. 1:100

emergjencës

Detaje të ndryshme Shk. 1:25/ 1:20/
1:10

Skema të kuadrove elektrike

Projekti i evakuimit dhe MNZ

Planimetritë e evakuimit Shk. 1:100

Planimetritë e instalimeve MNZ Shk. 1:100

Planimetritë e vendosjes së shuarësve Shk. 1:100

- Jo të gjitha objektet i kërkojnë të gjitha pikat e mësipërme të Vizatimeve të projektit përfundimtar të zbatimit.

Projekti përfundimtar i zbatimit do të dorëzohet si material i printuar dhe elektronik. Projekti i zbatimit do të dorëzohet në 3 kopje të printuara dhe një kopje një CD në PDF e firmosur elektronikisht nga Operatori ekonomik gjithashtu elektronikisht të dërgohet i gjithë projekti i punuar në DWG.

Vizatimet e projektit të zbatimit duhet të dorëzohen në format A3 sipas sipërfaqes së objektit.

Relacionet, specifikimet teknike, preventivi dhe grafiku i punimeve do të dorëzohen në format A4.

Projekti do të dorëzohet pranë Autoritetit Kontraktor brenda afatit të përfundimit të kontratës me shoqërinë projektuese.

Shenim:

Operatori fitues duhet të konsultohet gjatë gjithë kohës me Autoritetin Kontraktor për riorganizimin e hapësirave të brendshme aty ku është e nevojshme, përzgjedhjen e materialeve, ngjyrave, dizajni i rifiniturave, ambjenteve, banakëve dhe për mënyrat e preferencat e zgjidhjes arkitektonike.

Vlera Totale e investimit për 40 zyrat postare do të jetë 80,400,000 lekë pa Tvsh.

Vlera e hartimit të projekteve të llogaritet në bazë të vendimit Nr. 354, datë 11.05.2016 “PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË TARIFAVE PËR SHËRBIME NË PLANIFIKIM TERRITORI, PROJEKTIM, MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM” duke u nisur nga vlera e investimit.

Shtojca 9

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Dokumentat Standarde të Tenderit

Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		

Shtojca 10

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Kërkohet hartimi i projekt - preventivave për punimet e rikonstruksioneve të Objekteve të Postës Shqiptare sh.a, për 40 objekte sipas filialeve të Posta Shqiptare sh.a, që synon të krijojë ambiente bashkëkohore pune, rritjen e cilësisë së shërbimeve, përmirësimin e imazhit të saj, ambjenteve përreth dhe infrastrukturës.

Afati kohor për hartimin i projekt - preventivave për punimet e rikonstruksioneve të Objekteve të Postës Shqiptare sh.a, për 40 objekte sipas filialeve të Posta Shqiptare sh.a: do të jetë 45 (dyzet e pesë ditë) kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

- Është hartimi i projekt - preventivave për punimet e rikonstruksioneve të Objekteve të Postës Shqiptare sh.a, që synon të krijojë ambiente bashkëkohore pune, rritjen e cilësisë së shërbimeve, përmirësimin e imazhit të saj, ambjenteve përreth dhe infrastrukturës.
- Projektet e rikonstruksioneve të këtyre Objekteve, duhet të realizojnë dhe mundësojnë studimin dhe analizimin e problemeve ekzistuese si dhe dhënien e zgjidhjeve më optimale për realizimin e qëllimit përfundimtar.

Detyrat:

Projekti për rikonstrukcionin e Zyrrave Postare do të hartohet në përputhje me kërkesat e detyrës së projektimit dhe kushteve teknike të projektit të zbatimit.

Projekti përfundimtar do të përfshijë vizatimet për të gjitha punimet që do kryhen, specififikimet teknike për të gjitha punimet e parashikuara, relacionin teknik përshkrues të punës për secilin prej punimeve, preventivin e punimeve të parashikuara dhe grafikun e punimeve për secilin Filial më vete.

Konsulenti, në përputhje dhe në varësi të projektit të paraqitur duhet të paraqesë edhe preventivin përfundimtar përkatës.

Konsulenti duhet të paraqesë detyrimisht preventivin përfundimtar të punimeve. Çdo zë i këtij preventivi duhet të mbështetet në Klasifikimet Ligjore të Kostove dhe Analizat Teknike të Çmimeve nga Manualët Teknike përkatëse, në përputhje me VKM në fuqi.

Për zërat që nuk përfshihen në këto Manuale të bëhet analiza e çmimit bazuar në testimin e tregut duke marrë tre oferta nga operatorë ekonomike, që operojnë në vendin tonë (oferta që do të bëhen pjesë e dokumentit të dorëzuar) ose analiza të reja teknike.

Çmimet për projektim do të jetë sipas standarteve të shtetit Shqiptar.

Projekti Arkitektonik

Planvendosja e objektit	Shk. 1:500
Planimetritë e gjendjes ekzistuese	
Planimetritë e ndërhyrjeve	Shk. 1:100
Planimetritë e propozuara teknike	Shk. 1:100
Prerje gjatësore dhe tërthore	Shk. 1:100
Detaje të ndryshme arkitektonike	Shk. 1:25/ 1:20/ 1:10

Projekti Hidraulik

Planimetritë e furnizimit me ujë	Shk. 1:100 / 1:50
Planimetritë e shkarkimit të ujrave të zeza	Shk. 1:100 / 1:50
Detaje të ndryshme hidraulike	Shk. 1:25/ 1:20/ 1:10

Projekti Mekanik (Ngrohje Ftohje)

Planimetritë e vendosjes së pajisjeve ng-ft	Shk. 1:100
Planimetritë e shtrirjes së instalimeve të kondicionimit	Shk. 1:100
Detaje të ndryshme	Shk. 1:25/ 1:20/

1:10

Projekti Elektrik

Planimetritë e ndriçimit	Shk. 1:100
Planimetritë e prizave	Shk. 1:100
Planimetritë e rrjetit LAN, telefoni	Shk. 1:100
Planimetritë e ndriçimit të emergjencës	Shk. 1:100
Detaje të ndryshme	Shk. 1:25/ 1:20/ 1:10
Skema të kuadrove elektrike	

Projekti i evakuimit dhe MNZ

Planimetritë e evakuimit	Shk. 1:100
Planimetritë e instalimeve MNZ	Shk. 1:100
Planimetritë e vendosjes së shuarësve	Shk. 1:100

- Jo të gjitha objektet i kërkojnë të gjitha pikat e mësipërme të Vizatimeve të projektit përfundimtar të zbatimit.

Projekti përfundimtar i zbatimit do të dorëzohet si material i printuar dhe elektronik. Projekti i zbatimit do të dorëzohet në 3 kopje të printuara dhe një kopje një CD në PDF e firmosur elektronikisht nga Operatori ekonomik gjithashtu elektronikisht të dërgohet i gjithë projekti i punuar në DWG.

Vizatimet e projektit të zbatimit duhet të dorëzohen në format A3 sipas sipërfaqes së objektit. Relacionet, specifikimet teknike, preventivi dhe grafiku i punimeve do të dorëzohen në format A4.

Projekti do të dorëzohet pranë Autoritetit Kontraktor brenda afatit të përfundimit të kontratës me shoqërinë projektuese.

Shpërndarja:

- **Shërbimi për** hartimin e projekt - preventivave për punimet e rikonstruksioneve të Objekteve të Postës Shqiptare sh.a, për 40 objekte do të jetë sipas filialeve të Posta Shqiptare sh.a:

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

- **Në Ambjentet e Filialeve** të Postës Shqiptare sh.a.

Shenim:

Operatori fitues duhet të konsultohet gjatë gjithë kohës me Autoritetin Kontraktor për

riorganizimin e hapësirave të brendshme aty ku është e nevojshme, përzgjedhjen e materialeve, ngjyrave, dizajni i rifiniturave, ambjenteve, banakëve dhe për mënyrat e preferencat e zgjidhjes arkitektonike.

Vlera Totale e investimit për 40 zyrat postare do të jetë 80,400,000 lekë pa Tvsh.

Vlera e hartimit të projekteve të llogaritet në bazë të vendimit Nr. 354, datë 11.05.2016 “PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË TARIFAVE PËR SHËRBIME NË PLANIFIKIM TERRITORI, PROJEKTIM, MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM” duke u nisur nga vlera e investimit.

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Dokumentat Standarde të Tenderit

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: d oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 2. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |
| 2. _____ | _____ |

Dokumentat Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15.

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Shërbimet –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontraktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të përkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.

- 2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autortiteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 5 Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtonte ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6 Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t’i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t’i përdori për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me

shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit

- 7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithësi.
- 7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigura.
- 7.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 7.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

Neni 8 Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit

- 8.1 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e References.
- 8.2 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.
- 8.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

Neni 9 Specifikime dhe Skicime

- 9.1 Në se kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të pregatisi të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranuar dhe të njohura në përgjithësi të pranueshme për Autoritetin Kontraktues dhe të marrë parasysh standartet më të fundit.

- 9.2 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë përgatitur në bazë asnjëse përse i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

Neni 10 Lejet dhe Liçensat

- 10.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

Neni 11 Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor

- 11.1 Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në oferten e Kontraktuesit.
- 11.2 Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktues zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Autoriteti Kontraktues është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.
- 11.3 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më të mira.
- 11.4 Kontraktuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkak i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Autoriteti Kontraktues.

Neni 12 Vendndodhja

- 12.1 Shërbimet duhet të kryhen në vendin ose vendet e specifikuara në kontratë.
- 12.2 Në se nuk është specifikuar vendi, Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të aprovojë vendin ose vendet e kryerjes së Shërbimeve, megjithatë, aprovimi nuk duhet të vonohet në mënyrë të paarsyeshme.

Neni 13 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale

- 13.1 Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithsi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoriteti Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.
- 13.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithsi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.

Neni 14 Çmimi i Kontratës

- 14.1 Çmimi i kontratës duhet të jetë çmimi i ofruar në oferten e Kontraktuesit dhe i pranuar nga

Autoriteti Kontraktues.

Neni 15 Afatet e Pagesës

- 15.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhet në kohë siç specifikohet në kontratë.
- 15.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes se Shqiperise në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës për botim.
- 15.3 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoriteti Kontraktues me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan shërbimet e kryera për të cilat duhet paguar.
- 15.4 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që janë kryer Shërbimet, dorëzimi është paraqitur ose arritur, ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më e vonë.
- 15.5 Data e pagesës do të jete dita që fondet debitoohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

Neni 16 Vonesa në Bërjen e Pagesës

Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Autoritetit Kontraktor, megjithëse kontraktuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare

Neni 17 Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

- 17.1 Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 18 Forca Madhore

- 18.1 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontrates, dëmet e likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.
- 18.2 Për qëllimet e këtij neni “Forcë Madhore” do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të

përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktues qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

- 18.3 Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoriteti Kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 19 Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

- 19.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.
- 19.2 Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të likuideojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontrates.
- 19.3 Autoriteti Kontraktues mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.
- 19.4 Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.
- 19.5 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkaku dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

Neni 20 Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar

- 20.1 Dëmet e likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:
- a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
 - b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
 - c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Neni 21 Negociatat dhe Amendamentet

- 21.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.
- 21.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.
- 21.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 22 Ndryshimi i Porosisë

- 22.1 Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të porosisë Shërbime shtesë deri në një **masë** që nuk i kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik.

Neni 23 Ndërprerja për Mosplotësim

- 23.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
- a) Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
 - b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.
- 23.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Neni 24 Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

- 24.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paafte të paguajë.
- 24.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 25 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

- 25.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.
- 25.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.
- 25.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e

pjesshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 26 Nënkontrata

- 26.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë
- 26.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontraktojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor dhe jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësinë e nënkontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.
- 26.3 Cdo nënkontraktor duhet të ketë të drejtë të marrë pjesë në prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për shërbimet që do të furnizojë.
- 26.4 Kur Kontraktuesi ka ndër mend të realizojë një pjesë të punimeve me nën-kontraktues, duhet të paraqesë në ofertë, sipas dokumentave të tenderit, gjithë dokumentacionin e kërkuar për nënkontraktuesin si dhe punimet konkrete që do të jape me nënsipermarrje.
- 26.5 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pamvarësisht nga sjellja e nënkontraktorit.

Neni 27 Transferimi i të Drejtave

Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

Neni 28 Sigurimi i Kontrates

- 28.1 Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontrates në shumën dhe formën e kërkuar.
- 28.2 Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 28.3 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.

Neni 29 Baza Ligjore

- 29.1 Kontrata do të rregullohet nga dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 30 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 30.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.
- 30.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 31 Përfaqësimi i Palëve

- 31.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.
- 31.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
- 31.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktoje shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 32 Lajmërimet

- 32.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.
- 32.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 33 Llogaritja e Afateve

- 33.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

KUSHTET E VEÇANTA **Shërbimet – Kërkesë për propozim**

Kushtet e veçanta të Kontratës hartohen në përputhje me objektin konkret të kontratës. Në rast se ka mospërputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojnë Kushtet e veçanta të kontratës.

Neni 1 Përkufizime

- 1.1 Autoriteti Kontraktor është _____
- 1.2 Kontraktuesi është _____

Neni 2 Sigurimi i kontratës

- 2.1 Sigurimi i kontratës në shumën prej *(10% të vlerës së ofertës)* duhet të ofrohet nga Kontraktuesi për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 2.2 Sigurimi i Kontratës do t'i lëshohet ose kthehet, menjëherë Kontraktuesit sipas formularit të mëposhtëm:
- _____
- _____
- _____

Neni 3 Fillimi i Kontratës

- 3.1 Zbatimi i kontratës duhet të fillojë më _____. Nëse nuk është specifikuar, zbatimi do të fillojë në datën që Kontraktuesi nënshkruan formularin e kontratës.

Neni 4 Vendndodhja e Shërbimeve

- 4.1 Shërbimet do të kryhen në: _____
- _____
- _____
- _____

Neni 5 Informacion që duhet dhënë nga Autoriteti Kontraktor

- 5.1 Brenda 15 ditësh nga marrja e sigurimit të kontratës, Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit informacionin dhe dokumentat e mëposhtme: _____
- _____
- _____
- _____

Neni 6 Kërkesat e Raportimit

- 6.1 Gjatë zgjatjes së kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë raporte për Autoritetin Kontraktor sipas formularit të mëposhtëm: _____
-

Neni 7 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale

- 7.1 Përpara fillimit të zbatimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktor me prova për siguracionin e përgjegjësisë profesionale me shumë minimale si vijon: _____
-

Neni 8 Kushtet e Pagesës

- 8.1 Pagesa për Shërbimet duhet bërë sipas skedarit të mëposhtëm: _____
-
- 8.2 Çdo pagesë e skeduar duhet bërë brenda _____ ditëve nga data e arritjes së marrveshjes për pagesën ose nga data e marrjes së kërkesës me shkrim për pagesë cilado që të jetë më vonë. Nëse është lënë e paplotësuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.
- 8.3 Monedha e pagesës do të jetë _____. Nëse është lënë e paplotësuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

Neni 9 Pagesa Paraprake

- 9.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë _____. Nëse është lënë e paplotësuar, Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.
- 9.2 Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda _____ ditëve nga marrja e sigurimit të kontratës.
- 9.3 Nëse jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet Kontraktuesit sipas formulës së mëposhtme: _____
-

Neni 10 Zbritja e garancisë së kontratës

- 10.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë
-

Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I PUBLIKIMIT TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË NËNSHKRUAR

Seksioni I Autoriteti Kontraktor

I.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri _____
Adresa _____
Tel/Fax _____
E-mail _____
Adresa në Internet _____

I.2 Lloji i autoritetit kontraktor:

Institucion Qëndror

Institucion i Pavarur

Njesite e Qeverisjes Vendore

Tjetër

Seksioni 2 Objekti i Kontratës

2.1 Numri i referencës së procedurës/lotit _____

2.2 Lloji i “Kontratave Publike për Shërbime”

Konkurs Projektimi

Shërbime Konsulence

Shërbime të tjera

2.2.1 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuader

Po

Jo

Nëse Po, lloji i Marrëveshjes Kuadër

Me 1 Operator Ekonomik

Me disa operatorë ekonomikë

Të gjitha kushtet janë të përcaktuara

Po

Jo

2.3 Përshkrim i shkurtër i kontratës

1 Fondi limit _____

2. Burimi i Financimit _____

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër _____

2.4 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja në muaj ose ditë

ose

duke filluar nga // me përfundim në //

2.5 Ndarja në LOTE:

Po

Jo

Nëse Po, numri i LOTEVE:

2.6 Opsionet:

Numri i rinovimeve të mundshme(nëse ka):

ose: nga në

2.7 Kontrate me nenkontraktim:

Po

Jo

Seksioni 3 Procedura

3.1 Lloji i procedurës:

E hapur

3.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) çmimi më i ulët

ose

B) oferta ekonomikisht më e favorshme

lidhur me rëndësinë: Çmimi **pikë**

etj. **pikë**

3.3 Numri i ofertave të dorëzuara:

Numri i ofertave të rregullta:

3.4. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë përdorur standartet e përgatitura nga Agjencia Kombetare e Shoqërisë së Informacionit:

Po

Jo

3.5. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rastin kur standartet janë të paaplikueshme, është marrë miratimi paraprak nga Agjencia Kombetare e Shoqërisë së Informacionit

Po

Jo

Seksioni 4 Informacion mbi kontratën

4.1 Numri i Kontratës: _____ Data e Kontratës //

4.2 Emri dhe adresa e kontraktorit

Emri

Adresa

Tel/Fax

E-mail

Adresa e Internetit

4.2.1 Emri dhe adresa e nenkontraktorit/eve

Emri

Adresa

Tel/Fax

Dokumentat Standarde të Tenderit

E-mail _____
Faqja e Internetit _____

4.3 Vlera totale përfundimtare e kontratës *(duke përfshirë lotet opsionet dhe nenkontraktimin):*

Vlera	_____	<i>(pa TVSH)</i>	Monedha	_____
Vlera	_____	<i>(me TVSH)</i>	Monedha	_____

4.3.1 Vlera totale e nenkontraktimit : _____

Vlera	_____	<i>(pa TVSH)</i>	Monedha	_____
Vlera	_____	<i>(me TVSH)</i>	Monedha	_____

4.4 Informacione shtesë

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi //

Shtojca 18

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike]

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri _____
Adresa _____
Tel/Fax _____
E-mail _____
Faqja në Internet _____

2. Lloji i procedurës: _____

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër _____

4. Numri i referencës së procedurës/lotit _____

5. Fondi limit _____

6. Vlera totale përfundimtare e kontratës *(duke përfshirë lotet opsionet dhe nenkontraktimin)*:

Vlera _____ (me TVSH) Monedha _____

Vlera e nenkontraktimit _____ me Tvsh Monedha _____

7. Data e lidhjes së kontratës _____

8. Emri dhe adresa e kontraktorit /nenkontraktorit

Emri _____
Adresa _____
Nr. NIPT _____

Shtojca 19

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]
[Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik]

FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS

[Data _____]

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Ne Emer te: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, dhe me kusht që *[emri i ofertuesit të përcaktuar fitues]* t'i jetë akorduar kontrata,

Ne vërtetojmë se *[emri i ofertuesit të përcaktuar fitues]* ka derdhur një depozitë pranë *[emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimeve]* në një shumë prej *[monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra]* si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me *[emri i autoritetit kontraktor]*

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos përmbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin e plotë të kontratës.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimeve]

Shtojca 20

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE ANULIMIT

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri _____
Adresa _____
Tel/Fax _____
E-mail _____
Faqja në Internet _____

1. Lloji i procedurës: _____

2. Numri i Referencës: _____

3. Objekti i kontratës _____

4. Fondi limit _____

5. Arsyet e Anulimit:

Bazuar në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 24, pika 1:

- a) ;
- b) ;
- c) ;
- ç) ;
- d) ;
- dh) ;

Etj. _____

6. Informacione shtesë

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi.

Shtojca 21

FORMULARI I ANKESËS PRANE AUTORITETIT KONTRAKTOR

Ankesë drejtuar: Autoriteti Kontraktor

Seksioni I. Identifikimi i Ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (psh, si individ, në partneritet, në

Dokumentat Standarde të Tenderit

bashkëpunim, në bashkim shoqërish).

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

Adresa

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Kodi Zip

Nr. Telefoni (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

Nr. Faksi (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

E-mail

Emri dhe pozicioni i zyrtarit të autorizuar që plotëson ankesën (ju lutem, shtypeni)

Firma e zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

Nr. Telefoni (duke përfshirë prefiksin e zonës)

Nr. Faksi (duke përfshirë prefiksin e zonës)

Seksioni II. Informacion për Procedurën

1. Numër Identifikimi

Plotësoni numrin e kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentat e tenderit, duke përfshirë llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë (psh, Kërkesë për Propozime(KP), Procedurë e Hapur(PH), Procedurë e Kufizuar(PK), Procedurë me Negociim(PN), Shërbim Konsulencë (SHK), Konkurs Projektimi (KP).

2. Autoriteti Kontraktor

Emri i autoritetit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

3. Vlera e Përlllogaritur e Prokurimit

Llogaritja e vlerës së kontratës (shuma e shprehur në shifra dhe fjalë)

4. Objekti i Kontratës

Përshkrim i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve që blihen.

5. Afati Përfundimtar për Dorëzimin e Ofertës

Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.

Data (viti/muaji/dita)

6. Data e Përcaktimit të Kontratës Fituese

Data (viti/muaji/dita) nëse zbatohet

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza Ligjore e Ankesës

(shkruani shkeljen ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumenta, etj)

2. Deklaratë e Hollësishme e Fakteve dhe Argumenteve

Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin ankesën tuaj. Për çdo arsye të ankesës specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e ankesës. Përmendni edhe seksionet perkatëse të dokumentave të tenderit, nëse zbatohen. Përdorni faqe shtesë, nëse është e nevojshme.

3. Lista e Shtojcave

*Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë. Bashkangjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumentave që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre dokumentave. Dokumentat duhet të përfshijnë normalisht **çdo njoftim të publikuar, të gjitha dokumentat e tenderit, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj**. Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumentave perkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për prokurimin, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë **autoritetit kontraktor**

Shënim: Për ankesat pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet t'i referoheni Formularit të Ankesës se nxjerrë nga ky institucion.

Nr. Faks:

E-mail:

Nenshkrimi dhe Vula e ankuesit

Shtojca 22

DRAFTI I MARRËVESHJES KUADËR
(KU TE GJITHA KUSHTET JANË TË PËRCAKTUARA)
PER PUNË / MALLRA / SHËRBIME

[Përdorimi i ketij draft marrëveshje është detyruese për të gjitha Autoritetet Kontraktore që do të përdorin marrëveshjen kuadër)

Nr __

DATA:

Kjo kontratë lidhet më [data], midis [emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor] tani e tutje të referuar si “Autoriteti Kontraktor” dhe [emri dhe adresa e Kontraktuesit] të përfaqësuar nga [përfaqësuesi], tani e tutje i quajtur si “Kontraktuesi”.

Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë [data] bie dakord të furnizojë mallrat, ashtu siç janë të specifikuara në kushtet e përcaktuara në:

- Këtë kontratë
- Formulari i Deklarimit të Ofertës, të paraqitur nga Ofertuesi
- Specifikimet Teknike
- Formulari i çmimit të ofertës

Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitur përbëjnë pjesë integrale të kësaj kontrate.

Neni 1 Objekti

- 1.1 Objekti i marrëveshjes kuadër është të përcaktojë kushtet, përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat për dorëzimin e mallrave/shërbimeve/punëve në vijim.

[përshkrimi i përgjithshëm]

- 1.2 Marrëveshja kuadër do të zbatohet me dërgimin e ftesave për ofertë tek operatorët ekonomikë, palë në marrëveshje. P.sh. kurdoherë që Autoriteti Kontraktor i përfshirë në këtë marrëveshje, do të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate, duhet që të dërgojë “ftesën për ofertë” tek kontraktuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.

- 1.3 Sasitë e parashikuara, janë vetëm sasi orientuese dhe NUK e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t'i blerë ato. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të parashikuara.

- 1.4 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do t'i lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktor vendosë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të specifikuara dhe/ose në rast se autoriteti kontraktor vendos të mos blejë asnjë nga këto sasi për disa artikuj.

- 1.5 **Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër**
-

Neni 2 Çmimi

- 2.1 Çmimet për njësi për punë/mallra /shërbime janë treguar në Formularin e Çmimit të Ofertës.
- 2.2 Çmimet e njërive duhet të jenë fikse dhe nuk duhet t'i nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura në këtë marrëveshje kuadër.

Nënshkrimet dhe Datat

Për Kontraktuesin		Për Autoritetin Kontraktues	
Emri:		Emri:	
Pozita:		Pozita:	
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	
Vula:		Vula:	

Shtojca 23

DRAFTI I MARRËVESHJES KUADËR
(KU JO TË GJITHA KUSHTET JANË TË PËRCAKTUARA)
PËR PUNË / MALLRA / SHËRBIME

Emri i Autoritetit Kontraktor,

Dhe

Emri i Kontraktuesit

Bien dakord si vijon:

Të nënshkruajnë këtë marrëveshje kuadër për Kryerjen e: < vendosni titullin > me numrin identifikues : <vendosni Numrin e Prokurimit>

Neni 1 Objekti

1.1 Objekti i kësaj marreveshje kuadër është të vendosë rregullat për kontratat të cilat do të lidhen përmes procesit të mini-konkursit vetëm ndërmjet operatorëve ekonomike që janë palë e kësaj marrëveshje kuadër.

1.2 Kjo marrëveshje kuadër nuk është një kontratë në vete por përcakton kushtet për kontratat që do të lidhen në bazë të saj.

1.3 Kontraktuesi është vetëm një nga palët e marrëveshjes kuadër.

Neni 2 Detyrimet e Palëve

2.1 Autoriteti Kontraktues, palë në këtë marrëveshje, do t'i dërgojë kontraktuesit “Ftesën për Oferte” kurdo që paraqitet nevoja për punë/mallra/shërbime.

2.2 Kontraktuesi, detyrohet të dorëzojë një ofertë kurdo që kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 3 Kontratat në zbatim të marrëveshjes kuadër

3.1 Kontratat do të nënshkruhen vetëm pas procesit të mini-konkursit.

Neni 4 Procesi i mini-konkurrencës

4.1 Procesi i mini-konkursit do të kryhet me të gjithë operatorët ekonomikë, palë në marrëveshjen kuadër, kurdoherë që paraqitet nevoja për punë /mallra/shërbime për Autoritetet Kontraktore.

4.2 Autoriteti Kontraktor do të rihapë konkursin në bazë të kushteve të njëjta ose të kushteve të tjera të vendosura në ftesën për ofertë, sipas përcaktimeve në dokumentat e tenderit.

4.3 Kurdoherë që paraqitet nevoja për punë/mall /shërbim Autoriteti Kontraktor duhet të përgatisë Ftesat për Oferte dhe t'ua dërgojë të gjithë operatorëve ekonomike, palë në marrëveshjen kuadër. Vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në Ftesën për Ofertë

Neni 5 Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër

Nënshkrimet dhe datat

Për Kontraktuesin

Për Autoritetin Kontraktues

Dokumentat Standarde të Tenderit

Emri :		Emri:	
Pozita:		Pozita:	
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	
Vula:		Vula:	